

EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5889
E premte, 27 shtator 2019
çmimi 0.40 €

100 prokurorë do të angazhohen për ditën e zgjedhjeve | **FAQE 5**



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", RAMUSH TAHIRI | **FAQE 4-5**

PAS 6 TETORIT KOSOVA DUHET TË KETË QEVERI TË PROGRAMEVE

Analisti politik Ramush Tahiri e ka vlerësuar të mirë dhe përmbajtjesore fushatën e deritanishme të subjekteve politike. Ai ka thënë se kjo frymë e fushatës duhet të jetë deri në fund. Megjithatë, në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re" Tahiri ka deklaruar se partitë politike dhe

kandidatët për kryeministër po u shmangen deklaramëve për temat e mëdha siç janë: tarifa, dialogu, raportet me bashkësinë ndërkombëtare, liberalizimi dhe agjenda evropiane. Sipas tij, nuk po ka prej tyre deklarime reale, por populiste. Tahiri ka thënë se zgjedhjet e 6

tetorit duhet të jenë të lira, demokratike dhe të pranuar nga të gjithë. Ai ka theksuar se koalicionet pas zgjedhjeve duhet të bëhen në bazë të renditjeve e programit dhe jo të ketë qeveri të pakicës. Sipas Tahirit, Kosova duhet të ketë qeveri të programeve

AKTUALE



**VDES ISH-PRESIDENTI
FRANCEZ ZHAK SHIRAK** **F. 12**

**HARADINAJ: IDEJA QË
KOSOVA TË JAPË DIÇKA NË
KËMBIM TË NJOHJES NGA
SERBIA ENDE ËSHTË MBI
TAVOLINË** **F. 3**

**FSK-ja E GATSHME PËR
OBLIGIMET QË DALIN NGA
ANËTARËSIMI NË 'KARTËN E
ADRIATIKUT - A5'** **F. 2**

EKONOMI

**FILLOJNË PAGESAT E PARA
TË SIGURIMEVE BUJQËSORE
PËR FERMERËT QË KANË
BLERË POLISA** **F. 9**



KULTURË

**GASHI NËNSHKRUAN
RREGULLOREN MBI PUNËN E
KËSHILLIT DREJTUES TË
INSTITUTIT ARKEOLOGJIK TË
KOSOVËS** **F. 5**

FUSHATA PËR ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PARLAMENTARE TË 6 TETORIT



**Veseli premtori
rritje të pensioneve
për 80 për qind**



**Osmani: Nuk ka para që e
blenë vullnetin e qytetarëve
të Kosovës**



**Kurti: Do t'ua kthejmë
dinjitetin punëtorit, bujkut,
studentit**



**Limaj: Nisma dhe partnerët e
saj do të shënojnë fitore
madhështore më 6 tetor**



**Haradinaj: Çdo vit do t'i
rrisim pagat nga 10 për qind**

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Emisari i BE-së për dialogun Kosovë - Serbi pritet të emërohet pas 7 tetorit

BRUKSEL, 26 SHTATOR - Vendimi për të emëruar një të dërguar të posaçëm të Bashkimit Evropian për dialogun për normalizimin e marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë është tashmë i sigurt, thonë burimet diplomatike për Shërbimin e Ballkanit të "Radios Evropa e Lirë". Sipas tyre, vendimi ka gjasa të shpallet pas dëgjimit të shefit të ardhshëm të politikës së jashtme të BE-së, Josep Borrell, në Parlamentin Evropian. Mësohet se Borrelli, i cili vazhdon të shërbejë si ministër i Jashtëm i Spanjës, i ka njoftuar me këtë ide edhe disa kolegë të

vendeve të tjera të BE-së. Diplomatët, megjithatë, ende nuk flasin për emra konkretë të emisarit të ardhshëm, por thonë se ai, së paku, duhet të ketë ose të ketë pasur pozitën e ministrit të Jashtëm. Seanca dëgjimore e Borrellit në Parlamentin Evropian është caktuar për datën 7 tetor, kur edhe pritet ta marrë konfirmimin zyrtar nga ky institucion. Ideja për emërimin e një të dërguar evropian për dialogun midis Kosovës dhe Serbisë erdhi pasi administrata amerikane emëroi Mathew Palmerin të dërguar të posaçëm për

Ballkanin. Ky vendim i Uashingtonit, në këmbim me sfondin politik të Borrellit, i cili vjen nga një vend që nuk e njeht pavarësinë e Kosovës, thuhet se ka ngritur çështjen e emërimit të një personi të ri që të merret drejtpërdrejt dhe në mënyrë aktive me dialogun Kosovë - Serbi. Procedura për emërimin e këtij emisari, sipas pritjeve të diplomatëve, duhet të përfundojë përpara se Borrelli ta marrë detyrën e shefit të diplomacisë evropiane, përkatësisht para 1 nëntorit të këtij viti.



Dialogu midis Kosovës dhe Serbisë, i cili tash e sa vjet është ndërprerë qëkur Kosova u ka vënë taksë prodhimeve të importuara nga Serbia, në nëntor të vitit të kaluar.

FSK-ja e gatshme për obligimet që dalin nga anëtarësimi në 'Kartën e Adriatikut - A5'

Gjenerali Rrahman Rama ka thënë se FSK-ja është e gatshme t'i marrë përsipër të gjitha obligimet që dalin nga anëtarësimi në 'Kartën e Adriatikut - A5', për të ndërvepruar dhe kontribuar për paqe dhe stabilitet në rajon dhe më gjerë si forcë e ndërtuar dhe e zhvilluar me standarde të NATO-s



gjitha aktivitetet trajnuese, por edhe ushtrimet e përbashkëta ndërmjet shteteve anëtare, përfshirë dhe EUCOM-in, për ngritjen e gatishmërisë dhe për përmirësimin e ndërveprimit gjatë operacioneve të përbashkëta për ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në rajon. Qëllim tjetër i rëndësishëm i kësaj iniciative rajonale ishte edhe mbështetja e shteteve që aspirojnë integrimin në NATO.

Gjenerali Rrahman Rama gjatë kësaj konference pati rastin t'u drejtohet pjesëmarrësve, duke theksuar procesin e tranzicionit si dhe të arriturat e FSK-së. Ai ka shtuar se FSK-ja po vazhdon t'i ngrehë kapacitetet e veta sipas Planit Gjithëpërfshirës të Tranzicionit. "FSK-ja si forcë e ndërtuar dhe e zhvilluar me stan-

darde të NATO-s është e gatshme t'i marrë përsipër të gjitha obligimet që dalin nga anëtarësimi në 'Kartën e Adriatikut - A5', për të ndërvepruar dhe kontribuar me kapacitetet e veta për paqe dhe stabilitet në rajon dhe më gjerë", ka thënë ai. Komandanti i FSK-së, gjeneral Rama, gjatë konferencës ka

zhvilluar takime dypalëshe me zëvendëskomandantin e EUCOM-it, gjeneralletenant Stephen Twitty, si dhe me kryesuesit e delegacioneve të vendeve pjesëmarrëse në konferencë. Tema të diskutimit gjatë këtyre takimeve kanë qenë: avancimi i bashkëpunimit në fushën e zhvillimit të kapaciteteve

të FSK-së, aktivitetet e përbashkëta trajnuese, gjithashtu edhe ofrimi i kapaciteteve trajnuese të FSK-së për zhvillim profesional të kapaciteteve të partnerëve tanë. Gjeneral Rama i falënderoi të gjitha shtetet anëtare të Kartës së Adriatikut A5 për përkrahjen e vazhdueshme për ndërtimin dhe forcimin e partneritetit.

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

TI RANË, 26 SHTATOR - Komandanti i FSK-së, gjeneralletenant Rrahman Rama, me ftesë të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, gjeneralbrigade Bardhyl Kollçaku, ka marrë pjesë në konferencën e shefave të mbrojtjes "Karta e Adriatikut A5", e cila është mbajtur në Durrës. Në këtë konferencë Rama ka shkuar së bashku me komandantin e Gardës Kombëtare të Ajovës, gjeneralmajor Benjamin Corell. Kjo konferencë, e cila është mbajtur nga data 24 shtator 2019 deri më 26 shtator 2019, kishte për qëllim t'i bashkërendojë të

Gjermania vendos kushte të reja për Shqipërinë

TI RANË, 26 SHTATOR - Bundestagu gjerman diskuton të enjten në mbrëmje për Shqipërinë. Parlamenti gjerman pritet të vendosë për paketën e amendamenteve të paraqitura nga grupimet CDU/CSU dhe SPD, të cilat kanë vendosur 9 kushte për Shqipërinë për hapjen e procesit të negociatave të Shqipërisë me BE-në. Në Bundestag janë paraqitur dhe pritet të diskutohen të enjten, edhe tri kushte të reja nga Partia e të Gjellbërve, edhe pse një përfaqë-

sues i kësaj force politike, Manuel Sarrazin, një ditë më parë kritikoi grupimet më të mëdha në politikën gjermane që vendosën kushte ndaj Shqipërisë. Të gjelbërit kanë depozituar tri kushte për Shqipërinë. Kushti i parë, të krijohen strukturat e pavarura gjyqësore siç parashikohet në kushtetutë. Kushti i dytë, krijimi i agjencive të specializuara për ta luftuar krimin dhe korrupsionin. Kushti i tretë, përmirësimi i reko-

rdeve të hetimeve proaktive, ndjekjeve penale dhe dënimeve përfundimtare në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, përfshirë në nivele të larta. Në parim, Qeveria Federale duhet t'i aprovojë negociatat e pranimit me Shqipërinë në Këshillin Evropian më 17 dhe 18 tetor 2019 vetëm me kushtin që konferenca e parë e pranimit të mos zhvillohet derisa Qeveria Federale t'i ketë përcaktuar se 9 kushtet të jenë përmbushur nga Shqipëria.



Kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, është kthyer nga Shtetet e Bashkuar të Amerikës (ShBA)

Haradinaj: Ideja që Kosova të japë diçka në këmbim të njohjes nga Serbia ende është mbi tavolinë

Pas kthimit nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA), kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, ka thënë se në takimet që ka pasur me zyrtarët e lartë amerikanë dhe gjermanë në Nju Jork, ka qartësuar pozicionin e Kosovës në procesin e dialogut me Serbinë. Ai ka përsëritur edhe një herë se në këtë proces nuk do të ketë lëvizje të kufijve dhe ndarje të Kosovës. Megjithatë, ai ka pranuar se ende është në tavolinë ideja që Kosova të japë diçka në këmbim të njohjes nga Serbia

**EPOKA
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 26 SHTATOR - Kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, të enjten pasdite është kthyer nga vizita në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA), ku ka treguar arsyet e kësaj vizite. Në një konferencë për media, ai ka deklaruar se kjo vizitë ka qenë shumë e rëndësishme për t'i qartësuar pozicionet e Kosovës në procesin e dialogut me Serbinë. Ai ka përsëritur edhe një herë se në këtë proces nuk do të ketë lëviz-

je të kufijve dhe ndarje të Kosovës. "Ka qenë me rëndësi edhe tash me qenë atje, pasi edhe presidenti Vuçiq, edhe Serbia dhe gjithë të tjerët janë jashtëzakonisht aktivë. Njëkohësisht ka qenë me rëndësi të flasim edhe për pamundësinë që Kosova të adoptojë ndonjë model sikurse Bosnja në të ardhmen. Pra, ka qenë tepër e rëndësishme me qenë atje, sepse është moment kur bëhen shumë komunikime dhe nëse të gjithë ata shkojnë prej këtyre komunikimeve, pa ndonjë pikëpamje të duhur,

atëherë zhvillimet po marrin një drejtim të gabuar dhe më vonë po është shumë i vështirë korrigjimi i tyre, si rasti i mëherëshëm i idesë së shkëmbimit të territoreve ose ndërrimit të kufijve që nuk ka qenë e lehtë përballja me atë ide", ka thënë Haradinaj. Ai ka treguar se çka ka biseduar me zëvendësndihmëssekretarin Matthew Palmer dhe me përfaqësuesin e përhershëm të Gjermanisë në Kombet e Bashkuara, Christoph Heusgen. "E kam shfrytëzuar këtë prani që të bisedoj me përfaqësuesin

e përhershëm të Gjermanisë në Kombet e Bashkuara, Christoph Heusgen dhe me bashkatdhetarët tanë në ShBA. Këto takime janë bërë për temat kryesore. Ndërkaq me Palmerin patëm temë bilaterale Kosovë - Amerikë, për mundësinë e arritjes së marrëveshjes Kosovë - Serbi", ka thënë Haradinaj. Kryeministri në detyrë ka bërë me dije se presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, vazhdon të vajttojë që nuk po ndodhë ndarja e Kosovës. Sipas tij, ende është mbi tavolinë ideja që Kosova të japë diçka në këmbim të njohjes nga Serbia. "Është gabim drejtimi që ka marrë Vuçiqi. Ai ende po vazhdon të vajttojë që nuk po ndodhë ndarja e Kosovës. Dëshiron t'i japim 950 hektarë e ai 'ndonjë hektar' e të bëjë shaka me Kosovën. Pra, ideja se ne duhet ta marrim njohjen duke dhënë diçka ende është në tavolinë", ka thënë

Haradinaj, duke shtuar se Kosova mund t'i ofrojë Serbisë normalizim të marrëdhënieve. "Ne mund ta kthejmë tregun, pra taksa të hiqet për njohje, por është gabim logjika e Vuçiqit, pengimi i Kosovës. Në fakt, t'ju them sinqertë, ai nuk po e pengon Kosovën, ai po e pengon Serbinë. Ai s'do të mund të ecë drejt BE-së apo drejt ndonjë zhvillimi tjetër duke e penguar Kosovën. Këtë ia kanë bërë me dije të gjithë", ka vlerësuar Haradinaj. Gjatë vizitës në ShBA Haradinaj ka takuar edhe bashkatdhetarët të cilët i ka nderuar për angazhimin e vazhdueshëm për të mirën e Kosovës. "Ata vërtet meritojnë falënderim, sepse e kanë lartësuar të drejtën e shqiptarëve në Amerikë, njëkohësisht i kanë ndihmuar Amerikës që ta kuptojë këtë të drejtë dhe të na përkrahë", ka deklaruar Haradinaj.



KOZ-ja akrediton rreth 13 mijë vëzhgues

PRISHTINË, 26 SHTATOR (ER) - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka mbajtur mbledhjen e radhës të enjten në të cilën ka akredituar edhe 9

050 vëzhgues për zgjedhjet e 6 tetorit. Sipas KQZ-së, numri i vëzhguesve të akredituar është rreth 13 mijë. Kërkesën për t'u akredituar për vëzhgimin e

zgjedhjeve kanë mundur ta dorëzojnë: subjektet politike të certifikuar, OJQ-të, organizatat qeveritare dhe ndërqeveritare, organizatat ndërkombëtare të

specializuara të cilat merren me zgjedhjet dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përfaqësuesit e vendeve të huaja dhe mediet.



Flet për "Epokën e re", Ramush Tahiri

Pas 6 tetorit Kosova duhet të ketë qeveri të programeve



Analisti politik Ramush Tahiri e ka vlerësuar të mirë dhe përmbajtjesore fushatën e deritanishme të subjekteve politike. Ai ka thënë se kjo frymë e fushatës duhet të jetë deri në fund. Megjithatë, në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re" Tahiri ka deklaruar se partitë politike dhe kandidatët për kryeministër po u shmangen deklaramëve për temat e mëdha siç janë: tarifa, dialogu, raportet me bashkësinë ndërkombëtare, liberalizimi dhe agjenda evropiane. Sipas tij, nuk po ka deklarime reale, por populiste. Tahiri ka thënë se zgjedhjet e 6 tetorit duhet të jenë të lira, demokratike dhe të pranuar nga të gjithë. Ai ka theksuar se koalicionet pas zgjedhjeve duhet të bëhen në bazë të renditjeve e programit dhe jo të ketë qeveri të pakicës. Sipas Tahirit, Kosova duhet të ketë qeveri të programeve

liberalizimit të vizave. Pse ka ndodhur kjo?

Tahiri: Po duket një lloj mosguximi apo lojë me qytetarët sepse nuk po deklarohen për temat e mëdha siç janë: tarifa, dialogu, raportet me bashkësinë ndërkombëtare, liberalizimi dhe agjenda evropiane. Nuk po kemi deklarime reale, por deklarime populiste. Ata, duke e ditur se taksa është shumë popullarizuese, nuk po kanë guxim fort t'ia sqarojnë popullit dhe të deklarohen për qëndrimin e drejtë. Prandaj, po kemi një fshehje të qëndrimeve të liderëve dhe të partive që po paraqiten se janë të fuqishëm, mirëpo nuk po tregojnë se si do t'i marrin ato vendime të mëdha.

"Epoka e re": Cilat janë pritjet tuaja nga zgjedhjet e 6 tetorit?

Tahiri: Është e rëndësishme që zgjedhjet të jenë të lira, demokratike dhe të pranueshme. Duhet të arrihet një marrëveshje që partia e parë ta ketë të drejtën e kryeministrit dhe mos të ndodhë që partitë e vogla, vetëm për shkak të koalicionit, të marrin më shumë sesa forca reale e tyre e treguar në zgjedhje. Vota e qytetarëve duhet të jetë reale, pra nëse një parti i ka fituar 7 për qind, atë përqindje duhet ta ketë edhe në qeveri dhe jo sikurse në mandatin e kaluar kur partitë kanë pasur më shumë ministra sesa deputetë. Qytetarët po ndihen të zhgënjyer me pazaret që po bëhen për koalicione. Për mendimin tim, më mirë është që sërish të shkohet në zgjedhje sesa të bëhen lëshime joparimore vetëm sa për ta formuar qeverinë. Por nëse rritet përqindja e daljes

së qytetarëve në zgjedhje, normalisht se fitojnë më shumë vende partitë jomilitante, pra partitë që janë pak a shumë rreth qendrës, liberale, popullore e të tjera. Mirëpo nëse përqindja e qytetarëve është më e vogël në zgjedhje do të fitonin më shumë partitë militante.

"Epoka e re": Si e shihni qeverinë e ardhshme? Prisni koalicione të mëdha apo koalicione të vogla?

Tahiri: Pas zgjedhjeve koalicionet i shoh programore dhe parimore, pa vija të kuqe. Pra, duhet bërë programi i cili shqyrtohet çdo tre muaj në Kuvend. Në këtë drejtim krejt partitë i shoh edhe fajtores, edhe kontribuuese. Nëse bëhet qeveria me klientelë atëherë mund të ketë pasoja nga elektorati. Nëse vazhdon kjo luftë në mes të LV-së dhe LDK-së, është problem të ndodhë koalicioni. Nëse LV-ja del e para dhe vazhdon kështu, duke i kritikuar të gjithë, atëherë ta dorëzojë mandatin sepse nuk ka me kënd ta bëjë qeverinë. Mirëpo, në këto 4-5 ditë pres që partitë mos ta akuzojnë shumë njëra-tjetrën. Rezultatet e zgjedhjeve duhet të jenë të pranuar nga të gjitha dhe koalicionet pas zgjedhjeve duhet të bëhen në bazë të renditjeve dhe programit si dhe mos të kemi qeveri të pakicës. Pra, duhet të kemi qeveri të programeve. Po ashtu, pas zgjedhjeve mendoj se në qeveri nuk duhet të merret Lista Serbe, por partitë e tjera serbe që fitojnë zgjedhjet, meqë në Kushtetutë parashihet përfshirja e partive që përfaqësojnë interesat e minoritetit.

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 26 SHTATOR -

"Epoka e re": Z. Tahiri, si e komentoni fushatën e deritanishme të partive politike për zgjedhjet e 6 tetorit?

Tahiri: Fushata ka filluar shumë më herët, por të mërkurën është hapur zyrtarisht. Deri më tani të gjitha partitë kanë bërë fushatë të mirë, konstruktive dhe nuk ka pasur kritika kundër njëri-tjetrës, ndonëse ka pasur nga pak cinizëm dhe alegori. Sipas mendimit tim, është një fushatë e mirë, me një mobilizim të elektoratit, që mund të sjellë dalje më të madhe të qytetarëve në zgjedhje, rreth 55-60 për qind.

"Epoka e re": Çfarë vlerësimi keni për kandidatët për kryeministër dhe programet e tyre?

Tahiri: Të gjitha programet politike po afrohen rreth qendrës dhe socialdemokracisë si koncept, sepse flasin për politika sociale, për barazinë sociale, për pensionistët si dhe të gjitha po flasin për forcimin e shtetit dhe kundër korrupsionit. Në këtë

drejtim qytetarët e kanë problem të përcaktohen se kujt duhet t'ia japin votën, por e rëndësishme është pjesëmarrja në votim. Nuk shoh dallime në programe sepse cilindo që ta votosh është program i mirë. Për mua është simpatike që kemi edhe disa parti të tjera serbe, përveç Listës Serbe, që do të thotë se ka diferencim programor të qytetarëve.

"Epoka e re": Sa janë të zbatueshme këto programe dhe sa janë reale premtimet që po bëhen?

Tahiri: Është çështje tjetër kjo nëse këtyre programeve duhet t'u zihet besë dhe sa mund të realizohen. Janë disa arsye pse qytetarët i votojnë subjektet e caktuara. Secila parti ka një numër të caktuar të militantëve partiakë si dhe klientelizëm, votues që janë të lidhur me punësimet në shtet. Por kemi edhe votues të rinj 50-60 mijë sosh që do të votojnë për herë të parë e që nuk besojnë shumë se përmes votimit mund të ndryshohet diçka. Edhe koalicionet parazgjedhore do të ndikojnë pak a shumë në orientimin e votuesve. Po ashtu, kemi

subjekte politike që kanë ndikim në zona të caktuara dhe dalje masive në ato zona që ua rritë numrin partive të caktuara. Bazuar në rezultatin e tanishëm, të gjitha janë te 20-25 për qind, por befasitë mund të ndodhin te secila parti. Kjo varet nëse do të ketë rritje të numrit të qytetarëve që dalin në zgjedhje, pastaj edhe prej votuesve që votojnë për herë të parë. Në këto zgjedhje do të ketë ndikim edhe ajo që partitë e mëdha kanë garuar të vetme dhe jo në koalicione të mëdha. Secila parti programin dhe fushatën po e bën për fitore. Secila parti me propagandë ndaj njëra-tjetrës mundohet të tërheqë votues të rinj, por sa do të kenë sukses mbetet të shihet sikurse që mbetet të shihet edhe realizimi i programeve dhe premtimeve. Por, në përgjithësi, programet janë të mira dhe premtimet nuk janë pa mbulesë.

"Epoka e re": Deri më tash, në takimet me qytetarë, kandidatët për kryeministër janë treguar të kujdesshëm, duke iu shmangur temës së dialogut, shifrave të mëdha të punësimeve si dhe

Veseli premton rritje të pensioneve për 80 për qind

PRIZREN, 26 SHTATOR (ER) - Kandidati i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) për kryeministër, Kadri Veseli, ka mbajtur një tubim me qytetarë në Palestrën e Sporteve në Prizren. Ai ka thënë se ka shumë entuziazëm te prizrenasit për fitoren e Partisë Demokratike të Kosovës. Veseli ka premtuar se do t'ua rrisë pensionet për 80 për qind të gjithë pensionistëve në Kosovë. Ai para simpatizantëve të shumtë të PDK-së ka thënë se ky është një entuziazëm i njerëzve që e duan vendin e vet, qytetin e vet dhe e duan fitoren e Partisë Demokratike të Kosovës. "Oponentët tanë po çuditen pse kjo përkrahje për ne. Sepse ne nuk flasim, por veprojmë dhe vendosim. Sepse ne nuk shajmë, nuk ndajmë, por pajtojmë, afrojmë dhe bashkojmë. Ne jemi të vetmit që marrim vendime kundër korrupsionit dhe nepotizmit. Jemi të vetmit që kemi projekte për Kosovën. Kjo është rruga e fitores, rruga e besimit për



qytetarët tanë", u shpreh Veseli. Kandidati i PDK-së për kryeministër ka thënë se kushdo që është për ekonominë e dijes, për ndërmarrësinë dhe ekonominë prodhuese e ka vendin këtu dhe në PDK. "Unë do të punoj fuqishëm, do të jem përkrah çdo qytetari të vendit tim. Do të jem

përkrah rinisë dhe e kam një mesazh për të rinjtë: kjo është toka jonë e shenjtë, ne duhet bashkërisht të jetojmë këtu, të krijojmë familje këtu. Ky është vendi ynë. Do t'ju përkrah të gjithëve, secilin prej jush, të rinjtë, fermerët, bletarët, inovatorët, ndërmarrësit. Nuk do të ketë në qeverisjen time asnjë tatim të ri, por do të ketë përkrahje për të gjithë ju", ka thënë ai. Lideri i PDK-së ka theksuar se nuk do të ketë më prona private ku jetojnë qytetarët tanë pa fleta poseduese. Ai ka thënë se menjëherë brenda dy vjetëve do ta bëjë legalizimin e të gjitha pronave pa fleta poseduese. Për familjet e dëshmorëve dhe luftëtarët e lirisë, ai ka premtuar projekte të veçanta. "Është e shenjtë liria jonë. Është e shenjtë

sakrifica jonë. Kushdo që e do Kosovën, duhet ta dojë edhe Amerikën. Jua jap besën se Prizrenin, kryeqytetin historik të shqiptarëve, do ta bëj vendin më të bukur të shqiptarëve kudo që jetojnë", ka thënë Veseli. Ai ka thënë se Vetëvendosje po i mashtron të gjithë ashtu siç i ka

mashtuar prizrenasit. Nga kjo mbrëmje madhështore Veseli i ka ftuar të gjithë që të bëhen bashkë, që të mos ndahen sepse, sipas tij, të gjithë duhet të kenë vetëm një mision, vetëm një qëllim: ta bëjmë Kosovën një vend më të zhvilluar ekonomikisht dhe të integruar në familjen euroatlantike.

Kandidati i PDK-së për kryeministër, Kadri Veseli, ka vazhduar fushatën edhe në Dragash e Zhur. Ai ka thënë se Dragashi dhe Zhuri i janë bashkuar vizionit të tij për të ardhmen e Kosovës. Veseli ka thënë se vetëm një qeveri e udhëhequr nga PDK-ja, me mbështetjen e miqve tanë, do ta zhvillojë ekonominë dhe do të krijojë vende të reja të punës. Lideri i PDK-së të enjten ka vizituar edhe bazën e "SHELL"-it në Kosovë, ku ka takuar punonjësit e kësaj kompanie. Me këtë rast, ai ka thënë se do ta forcojë diplomacinë ekonomike për të siguruar tregje të reja për eksportet e Kosovës.



100 prokurorë do të angazhohen për ditën e zgjedhjeve



EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 26 SHTATOR - Të enjten është mbajtur tryeza e organizuar nga Prokurori i Shtetit me moton "Mbrojtja e votës", në të cilën është diskutuar për angazhimin e përbashkët të institucioneve nënshkruese të memorandumit për zgjedhje (KQZ, PZAP, PSh, PK dhe KGJK). Në këtë tryezë është diskutuar lidhur me përgatitjet e institucioneve, bashkëpunimin dhe bashkërenditjen e aktiviteteve për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të cilat do të mbahen më 6 tetor si dhe për vetëdijimin

për parandalimin e manipulimeve të mundshme.

Koordinatorja Nacionale për Zgjedhje në Prokurorinë e Shtetit, Laura Pula, ka deklaruar se institucioni i Prokurorit të Shtetit tashmë ka caktuar 100 prokurorë së bashku me shtatë koordinatorë rajonalë, të cilët do ta monitorojnë gjithë procesin zgjedhor, si dhe ka potencuar se në rastet ku paraqiten problemet eventuale, do të ndërmerren të gjitha masat e nevojshme në bazë të kompetencave dhe ligjit.

Po ashtu, koordinatorja Pula u ka bërë ftesë të gjitha institucioneve përkatëse, shoqërisë civile dhe

medieve, që të bashkëpunojnë ngushtë, para, gjatë dhe pas procesit të zgjedhjeve me Prokurorin e Shtetit, të paraqesin çdo parregullsi eventuale në mënyrë që të ndërmerren masat e nevojshme për parandalimin e keqpërdorimit të votës.

Ndërkaq përfaqësuesi i Ambasadës Amerikane në Prishtinë, John Bush, u shpreh se ShBA-ja mbështet projektin "Mbrojtja e votës" si dhe i inkurajon të gjithë për t'i raportuar parregullsitë. Përfaqësues të institucioneve të tjera kanë prezantuar planet e tyre lidhur me angazhimet e tyre si dhe kanë deklaruar se të

gjithë janë duke u marrë me aktivitete të ndryshme në bazë të kompetencave që ka secili institucion përkatës.

Koordinatorja nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Fatime Dërmaku, ka thënë se kjo është hera e parë që janë të përfshirë në zgjedhje 15 gjyqtarë, të cilët do t'i mbulojnë të gjitha komunat e që, sipas saj, do të jenë në gatishmëri t'i shqyrtojnë kërkesat e prokurorëve për caktimin e masave ndaj personave që kanë kryer vepra penale. Po ashtu, drejtori i operacioneve në Policinë e Kosovës, Afrim Ahmeti, ka thënë se Policia e Kosovës është e gatshme të ofrojë siguri, para,

gjatë dhe pas procesit zgjedhor. Ndërsa koordinatori i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashpresa, Mul Desku, është shprehur se deri më tani kanë pranuar 89 ankesa, prej të cilave 86 janë shqyrtuar, të cilat kanë të bëjnë me fushatën si dhe ka theksuar se paneli është i gatshëm dhe po punon me kapacitet të plotë për shqyrtimin e ankesave. Kryeshefi ekzekutiv i Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Enis Halimi, u shpreh se përgatitjet për këto zgjedhje deri më tani janë duke shkuar mirë, duke shpresuar se do të kalojë i gjithë procesi pa ndonjë pengesë për procesin zgjedhor.

Osmani: Nuk ka para që e blenë vullnetin e qytetarëve të Kosovës

Në ditën e dytë të fushatës zgjedhore, kandidatja e LDK-së për kryeministre, Vjosa Osmani, ka ftuar që më 6 tetor të mbrohet vota e qytetarëve. Në një tubim elektorale në Komunën e Klinës ajo ka thënë se nuk ka para që e blenë vullnetin e qytetarëve të Kosovës



PRISHTINË, 26 SHTATOR (ER) - Kandidatja e Lidhjes Demokratike e Kosovës (LDK) për kryeministre, Vjosa Osmani, ka thënë të enjten, në tubimin elektorale në Klinë, se me gjithë përpjekjet e disa partive për të blerë vota, nuk ka para që e blenë vullnetin e qytetarëve të Kosovës. Ajo ka thënë se tashmë qytetarët e Kosovës kanë vendosur t'i besojnë LDK-së më 6 tetor. "Ne duhet të jemi vigjilentë që këtë vullnet kaq të qartë të qytetarëve të Kosovës për ta përkrahur LDK-në, ta mbrojmë. Duhet ta mbrojmë me çdo kusht, sepse ka parti që mendojnë se mund ta blejnë vullnetin e qytetarëve. Ka ardhur koha t'u thuhet se nuk ka para që e blenë këtë vullnet. Nuk ka asnjë kërcënim që e blenë dhe e ndal këtë vullnet. Nuk ka asgjë dhe asnjëri që mund ta ndalë fitoren e LDK-së", ka thënë Osmani.

Ajo ka adresuar kritika për kundërkandidatët, të cilët në këtë fushatë zgjedhore po flasin për vizion evropian. "Ne nuk flasin në një anë për vizion evropian e në anën tjetër për të lejuar kidnapim të qytetarëve të shteteve të tjera në shtetin tonë. Ne nuk lejojmë që në një anë të flasin për vizion evropian e të lejojmë që të vidhet në dhomat e dëshmime në polici. Po ashtu, nuk do të lejojmë që qeveria jonë çdo ditë të dalë në televizione për skandale korruptive. Vjedhja e shtëpisë tënde nuk është vlerë evropiane. Abuzimi i shtëpisë tënde nuk është vlerë evropiane sepse Kosova është shtëpia jonë", ka thënë Osmani, duke i ftuar klinasit që mos ta rrezikojnë shtetin duke e lënë atë në duart e partive të tjera.

Gjatë të ditës së enjte Osmani ka vizituar edhe Komplexin Memorial në Prekaz. Aty Osmani ka thënë se ish-presidenti Ibrahim Rugova dhe komandanti Adem Jashari kanë

ndërtuar themelet e shtetit të Kosovës. "Nderimi ynë për familjen Jashari, për komandantin legjendar Adem Jashari, i cili si një binom, bashkë me presidentin Rugova, ndërtuan themelet e shtetit të Kosovës, është i përhershëm dhe shër-

ben si një udhërrëfyes për çdo hap që ne e qesim në çdo proces të shtetndërtimit dhe në të gjitha sfidat që na dalin përpara, në fuqizimin e shtetit tonë dhe në zhvillimin e tij", ka thënë Osmani, e cila ka qenë e shoqëruar nga zyrtarë të LDK-

së. Ajo ka thënë se ka shkuar në Prekaz për ta nderuar sakrificën më sublime të luftës së fundit në Kosovë, atë të familjes Jashari. LDK-ja ka mbajtur takime elektorale edhe në Malishevë, Rahovec dhe Gjakovë.

Kurti: Do t'ua kthejmë dinjitetin punëtorit, bujkut, studentit

Kandidati për kryeministër i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka ftuar të enjten qytetarët e Komunës së Istogut që ta votojnë këtë subjekt politik më 6 tetor për ta ndryshuar qeverisjen në vend. Para simpatizantëve të kësaj lëvizje, ai ka premtuar se me qeverisjen e tij do t'ua kthejë dinjitetin punëtorit, bujkut dhe studentit



PRISHTINË, 26 SHTATOR (ER) - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje dhe kandidati për kryeministër, Albin Kurti, ka vazhduar të enjten fushatën në Komunën e Istogut, ku u ka bërë thirrje qytetarëve të kësaj komune të bashkohen me lëvizjen për ta ndryshuar vendin. Para simpatizantëve ai ka premtuar se me qeverisjen e tij do t'ua kthejë dinjitetin punëtorit, bujkut dhe studentit.

Ai ka thënë se ndryshimi është i domosdoshëm sepse atë po e kërkojnë studentët me diplomë e të papunë, fermerët që punojnë e nuk fitojnë, mërgata që ndihmon Kosovën e që nuk ndryshon, dhe punëtorët që punojnë shumë e paguhen pak. Për drejtësi gjyqësore ndaj të korruptuarve dhe drejtësi

sociale për qytetarët, kandidati për kryeministër, Albin Kurti, ka thënë se tash ka shpresë se do të kthehet dinjiteti i punëtorit, bujkut dhe studentit. "Le të bëhemi bashkë të gjithë për ta ndryshuar vendin për fëmijët tanë e për fëmijët që duhet të lindin e do të lindin për të na trashëguar ne sepse me Vetëvendosjen tash ka shpresë. Me Vetëvendosjen do ta kthejmë dinjitetin të punëtorit, bujku dhe studentit. Me Vetëvendosjen do ta zhvillojmë ekonominë, do ta avancojmë bujqësinë, do ta përmirësojmë arsimin dhe do ta rregullojmë shëndetësinë", ka deklaruar Kurti.

Ai ka kritikuar logjikën e deritanishme qeverisëse. "Me rrugë që lidhin fshatin me qytetin e jo

me autostrada që i varfërojnë edhe fshatin edhe qytetin, me ujësjellës që i bashkon fshatarët, me punëtorë që bashkohen me ligj të ri për mbrojtjen e tyre, fushata jonë fitimtare është vegimi paraprak i të gjithë Kosovës pas 6 tetorit",

është shprehur Kurti. Kurse kandidati për deputet, njëherësh kryetari i Qendrës së LV-së në Istog, Agron Avdijaj, ka deklaruar se aty ku qeveria është e madhe në numër, numri i qytetarëve të punësuar është shumë i vogël. Para simpatizan-

tëve të kësaj lëvizje kanë folur edhe kandidatët për deputetë, Fatmire Mullhaxha-Kollçaku, Shpejtim Bulliqi dhe Mimoza Kusari-Lila. Lëvizja Vetëvendosje të enjten ka mbajtur tubime elektorale edhe në Artanë dhe Ferizaj.

Haradinaj: Çdo vit do t'i rrisim pagat nga 10 për qind

Kandidati për kryeministër i koalicionit AAK - PSD, Ramush Haradinaj, ka premtuar rritje të pagës prej 10 për qindësh për çdo vit. Në tubimin elektorale në Prishtinë, aty ku ka treguar arsyen pse më 6 tetor duhet të votohet ky koalicion, Haradinaj ka thënë se do ta bëjë pagën minimale 250 euro



kishim Ramush Haradinaj. Në këtë sallë ku jemi do t'i ndajmë mbi katër milionë euro. Ligji për kryeqytetin thonë se nuk ishte punë e madhe. Kur ishte në pushtet PDK-ja e në komunë

LDK-ja, nuk e kalonin ligjin. Njëjtë ndodhi edhe kur në qeveri erdhi Isa Mustafa, por nuk e bëri. Por kështu nuk bëri Haradinaj. Ishte pikërisht qeveria Haradinaj që e dërgoi ligjin në Kuvend e sot

e kemi Ligjin për Prishtinën. Shumë shpejt do ta kemi Spitalin e Prishtinës, po edhe policinë. Të gjitha ato që parashihen në Ligjin për Prishtinën", ka thënë Ahmeti.

PRISHTINË, 26 SHTATOR (ER) - Koalicioni parazgjedhor AAK-PSD të enjten ka vazhduar fushatën elektorale në Komunën e Prishtinës, ku ka mbajtur takim me qytetarë. Kandidati për kryeministër i këtij koalicioni, Ramush Haradinaj, ka treguar se pse qytetarët e Kosovës më 6 tetor duhet ta votojnë këtë koalicion. "Ne kemi dhënë prova tash së fundi se jemi organizëm që dimë të funksionojmë. Ne edhe kur nuk kemi qenë në koalicion AAK - PSD në tema të interesit kombëtar, si rasti i ushtrisë, rasti i taksës, rasti i Ligjit për Trepçën, Ligji për kryeqytetin dhe Ligji për pagat, kemi ditur të veprojmë. Nuk na ka penguar asgjë për t'i marrë vendimet e drejta. Pra, ky

koalicion është funksional dhe nuk është një krijesë artificiale", ka thënë Haradinaj. Më tej, ai ka deklaruar se ky koalicion e ka ndalur edhe ndarjen e Kosovës. Haradinaj ka treguar edhe premtimet kryesore të këtij koalicioni, duke shtuar se ky koalicion mund t'i rritë pagat deri në 10 për qind për çdo vit. "Ne do ta bëjmë pagën minimale 250 euro, që nënkupton pastaj çdo pension, çdo pagesë publike mos të bie nën 250 euro", ka thënë Haradinaj. Kurse kryetari i PSD-së, Shpend Ahmeti, i cili është kryetar i Prishtinës, ka folur për Ligjin e kryeqytetit. "Kjo sallë nuk do të ishte e komunës po mos ta

Limaj: Nisma dhe partnerët e saj do të shënojnë fitore madhështore më 6 tetor

Kandidati për kryeministër nga koalicioni Nisma-AKR-PD, Fatmir Limaj, fushatën zgjedhore e ka vazhduar në Skenderaj. Në këtë qytet ai ka kërkuar nga qytetarët që të bëhen bashkë për shtetin dhe ta shtyjnë përpara frymën socialdemokrate. Ai ka thënë se Nisma dhe partnerët e saj do të shënojnë fitore madhështore në zgjedhjet e 6 tetorit



PRISHTINË, 26 SHTATOR (ER) - Koalicioni Nisma-AKR-PD të enjten ka vazhduar fushatën elektorale në Skenderaj dhe Ferizaj. Me këtë rast, lideri i Nismës Socialdemokrate, njëherësh kandidat për kryeministër nga radhët e këtij koalicioni, Fatmir Limaj, ka kërkuar mbështetjen e qytetarëve të Skenderajt për ta shtyrë përpara frymën socialdemokrate. "Në Skenderaj po i fillojmë tubimet e parapara nëpër komuna për ta shpalosur programin dhe vizionin tonë për

qeverisjen e ardhshme. Nga epiqendra e lëvizjeve të mëdha kombëtare ju ftoj të bëheni bashkë për shtetin dhe ta shtyjmë para frymën tonë socialdemokrate. Ne jemi bërë bashkë me të gjithë ata që duan të kontribuojnë për shtetin tonë, vendin dhe qytetarët", ka deklaruar Limaj, duke shtuar se Nisma Socialdemokrate dhe partnerët e saj do t'i fitojnë zgjedhjet. "Duke parë gjithë mbështetjen në terren, ne jemi të bindur se Nisma Socialdemokrate dhe partnerët e

saj do të shënojnë fitore madhështore në zgjedhjet e 6 tetorit. Festa nis në Skenderaj për të kulmuar më 6 tetor me fitoren spektakolare në Skenderaj dhe Kosovë", është shprehur Limaj. Ai ka kërkuar nga qytetarët e Skenderajt të mos i votojnë ata që i kanë zhgënjyer tash e shumë vjet. Për këtë arsye, sipas Limajt, duhet t'u jepet mundësia njerëzve të rinj. Kurse partnerja tjetër e koalicionit, Aleanca Kosova e Re (AKR), të enjten ka prezantuar programin e vet qeverisës në Ferizaj. Në mungesë të presidentit të

partisë, Behgjet Pacolli, i cili po qëndron për vizitë në ShBA, ka folur zëvendëspresidenti i AKR-së, Vesel Makolli, i cili ka kërkuar nga qytetarët e Ferizajt që ta votojnë numrin 122. "Behgjet Pacolli është ndërmarrës i cili e ka formuar një plan që mbështetet në shtyllat kryesore të shtetit dhe shoqërisë. Lista dhe programi ynë qeverisës janë ofertat më të mira për qytetarët", është shprehur ai. Ndërsa kandidati për deputet nga radhët e AKR-së, Islam Pacolli, është zotuar se koalicioni Nisma-AKR-PD do ta luftojë

korruptionin. Sipas tij, AKR-ja nuk e zvat shtetin, por e zhvillon atë. "Vetëm ne mund ta zhvillojmë vendin dhe mund ta luftojmë korruptionin", ka theksuar ai. Kurse kryetari i Partisë së Drejtësisë (PD), Ferid Agani, ka thënë se janë bërë bashkë për të ofruar kuadro dhe garanci për realizimin e premtimeve. "Ju ftoj ta votoni ndershmërinë, profesionalizmin dhe vlerat. Në koalicionin tonë jemi mbledhur për t'i ofruar kuadrot më të veçuara si garanci që premtimet tona zgjedhore do të realizohen", ka deklaruar Agani.



Betohen rekrutët e rinj të FSK-së

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 26 SHTATOR - Në repartet e kazermës "Adem Jashari" të Shtabit të Përgjithshëm të Forcës së Sigurisë të Kosovës në Prishtinë të enjten është zhvilluar ceremonia e betimit e rekrutëve të rinj, gjenerata 2023, të cilët e kanë filluar vitin akademik 2019/20 në Qendrën për Studime Universitare të

Akademisë së Mbrojtjes. Në ceremoni ishin të pranishëm ministri i Mbrojtjes Rustem Berisha, zëvendësministri Kadri Kastrati, komandanti i FSK-së, gjeneralletjenant Rahman Rama, ushtruesi i detyrës së sekretarit të përgjithshëm, Faruk Geci, komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërviçjes, gjeneralbrigade Irfete Spahiu, drejtori i Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s, gjeneral Michael Obernayer, gjeneralë,

oficerë të FSK-së dhe NALT-it, si dhe shumë familjarë e miq të rekrutëve të rinj.

Pas rreshtimit, inspektimit dhe intonimit të himnit shtetëror, fjalën e rastit e paraqiti ministri i Mbrojtjes Rustem Berisha, i cili këtë gjeneratë të rekrutëve e cilësoi si gjeneratën më me fat. "Kjo është një datë me rëndësi për FSK-në. Ju jeni gjenerata e parë e kadetëve që keni nderin t'i bashkoheni FSK-së me mandat të ri ushtarak. Sot duhet të jeni

krenarë për arritjet tuaja dhe zotoheni që gjithmonë do ta nderoni uniformën e FSK-së, ta nderoni atdheun, t'i respektoni eprorët tuaj dhe ta mbronin paqen, lirinë dhe shtetin tonë", ka thënë Berisha.

Ai ka shtuar se si ministër i Mbrojtjes është krenar me vajzat dhe djemtë tanë ushtarë, nënoficerë dhe oficerë, të cilët me sukseset e tyre në shkollat dhe trajnimet e përfunduara nëpër akademi të ndryshme të

vendeve të NATO-s, kanë treguar performancë të shkëlqyer dhe e kanë përfaqësuar me nder FSK-në. "Pres që edhe ju ta ndiqni shembullin e tyre", ka thënë ministri Berisha.

Në fund të ceremonisë, 14 rekrutët e rinj para komandantit të QSU-së, major Vegim Krelani dhe të pranishmëve të tjerë, solemnisht dhanë betimin si kadetë të FSK-së dhe nënshkruan kontratat për shërbim në FSK.



Gashi nënshkruan Rregulloren mbi Punën e Këshillit Drejtues të Institutit Arkeologjik të Kosovës



PRISHTINË, 26 TETOR (ER) - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka nënshkruar Rregulloren mbi Punën e Këshillit Drejtues të Institutit Arkeologjik të Kosovës. Plot 16 vjet pas themelimit të Institutit Arkeologjik të Kosovës, Këshilli Drejtues i këtij institucioni, i emëruar nga Ministri Gashi në mars të vitit 2019, ka përgatitur Rregulloren e Punës të Këshillit Drejtues të IAK-ut. "Jam i lumtur që ky Këshill i emëruar në mars të këtij viti ka bërë një punë të jashtëzakonshme për përgatitjen e Rregullosës së Punës së Këshillit Drejtues të IAK-ut", ka thënë ministri Gashi.

Ai ka thënë se Instituti Arkeologjik i Kosovës që nga themelimi i tij ka pasur mungesë të infrastrukturës ligjore. "Rregullorja është hapi i parë drejt kompletimit të infrastrukturës ligjore të këtij institucioni shumë të rëndësishëm të Trashëgimisë Kulturore të vendit tonë. U informova nga Këshilli Drejtues, që është në përfundim edhe të Statutit të IAK-ut, kurse unë si ministër i inkurajova anëtarët e Këshillit që ta vazhdojnë punën shumë të mirë që po e bëjnë", ka theksuar ministri Gashi.

Më tej, ministri Kujtim Gashi ka shtuar se do të jetë gjithmonë në

përkrahje të profesionistëve të cilët punojnë me përkushtim për ngritjen e nivelit institucional në bazë të ligjeve të shtetit tonë.

Instituti Arkeologjik i Kosovës deri më tani nuk ka pasur Rregullore të Këshillit Drejtues dhe as Statut të IAK-ut. Është hera e parë kur një ministër i MKRS-së i kushton vëmendje dhe përkrahje të pakursyer një trupe profesionistësh, siç është Këshilli Drejtues i IAK-ut që të punojë dhe të përgatisë dokumente të domosdoshme për funksionimin ligjor dhe të drejtë të Institutit Arkeologjik të Kosovës.

Në Spitalin Rajonal të Pejës vdes një i burgosur

PEJË, 26 SHTATOR (ER) - Shërbimi Korrektues i Kosovës ka njoftuar se sot rreth orës 03:15 në Spitalin Rajonal të Pejës ka ndërruar jetë i burgosuri me inicialet Z. LL., i lin-

dur më 1942. "I burgosuri, rreth orës 23:35, me rekomandim të mjekut të Q. K. Dubravë, është dërguar me urgjencë në Spitalin Rajonal të Pejës. Pavarësisht prej

ofrimit të ndihmës mjekësore, ka ndërruar jetë. Z. LL. po vuante nga sëmundje të zemrës dhe mushkërive. I njëjti ishte i dënuar për veprën penale

'vrasje e rëndë'. Sipas procedurave, trupi i pajetë është dërguar për obduksion", është thënë në njoftimin e Shërbimit Korrektues të Kosovës.



Fillojnë pagesat e para të sigurimeve bujqësore për fermerët që kanë blerë polisa

EPOKA
ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 26 SHTATOR - Për herë të parë në Kosovë kanë filluar pagesat e para të dëmshpërblimit për fermerët që kanë blerë polisat e para të sigurimit bujqësor në vend. Fermerët e Kosovës, me fillimin e sigurimit për prodhimet e tyre, do të kenë mundësi më të mira për të pasur më shumë siguri në kulturat bujqësore që i kultivojnë. Për gati dy vjet Korporata Ndërkombëtare Financiare (IFC, anëtare e Grupit të Bankës Botërore), në kuadër të projektit për financimin e bujqësisë në Evropë dhe Azi Qendrore, ka punuar ngushtë me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) për krijimin e sistemit të sigurimeve bujqësore në Kosovë. Sistemi i sigurimeve bujqësore është ndërtuar për ta përmirësuar konkurrencën dhe nxitur zhvillimin e sektorit të bujqësisë.

Në ceremoninë zyrtare të pagesave të para që është mbajtur në Prishtinë, pjesëmarrës ishin aktorët kryesorë të përfshirë në këtë projekt, duke filluar prej MBPZHR-së, IFC-së, Shoqatës së Kompanive të Sigurimit, kompanitë e sigurimit, fermerët dhe aktorët tjerë.

Drejtori i Departamentit për Politika Bujqësore dhe Tregje në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Isuf Cikaqi, ka deklaruar se MBPZHR-ja së bashku me IFC-në kanë zhvilluar gjashtë produkte të sigurimit bujqësor e që janë: molla, kumbulla, mjedra, dredhëza, rrushi dhe speci. "Në vitin 2019 kemi filluar me kulturën bujqësore të mjedrës e cila është kultura e parë bujqësore që është pilotuar për sigurim bujqësor.



Rezultatet e këtij pilotimi na kanë treguar që i tërë sistemi tashmë i krijuar i sigurimeve bujqësore indeks ka funksionuar si është më së miri. Prandaj, ne jemi të interesuar të vazhdojmë edhe me produkte të tjera për sigurimet bujqësore, duke filluar me rrushin që i fillon faza e sigurimit në muajin dhjetor", ka thënë Isuf Cikaqi.

Kurse Syzana Dautaj, koordinatore e projektit nga IFC-ja, ka thënë se sistemi i sigurimeve bujqësore implementohet për herë të parë në vend dhe tani bujqit në Kosovë mund t'i sigurojnë kulturat e tyre bujqësore, gjë që do t'ua mundësojë atyre uljen e rrezikut nga faktorët klimatikë dhe mbrojtjen e investimeve të tyre. "Duke pasur parasysh nevojat e tregut dhe interesimin e madh për një sistem modern dhe të qëndrueshëm të sigurimeve bujqësore, ne besojmë se të gjithë hisedarët bashkërisht do ta promovojnë dhe përdorin këtë sistem në mënyrë që të bëhet më i qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës në të ardhmen", ka thënë Dautaj.

Ndërsa në emër të Shoqatës së

Sigurimeve të Kosovës drejtori ekzekutiv i Shoqatës së Sigurimeve, Sami Mazreku, ka falënderuar IFC-në dhe MBPZHR-në për ndihmën që i kanë dhënë sektorit të sigurimeve në Kosovë për krijimin e sistemit të sigurimeve bujqësore për herë të parë në vend dhe për sjelljen e përvojave ndërkombëtare për tregun e sigurimeve në Kosovë. "Sot në këtë ceremoni zyrtarisht përcjellim pagesat e para të dëmshpërblimeve për fermerët e siguruar, njëkohësisht urojmë që shembullin e kompanisë Elsig dhe të fermerëve të siguruar ta përcjellin edhe kompanitë e tjera dhe fermerët, pasi shumë shpejt do të fillojë perioda siguruese për rrushin dhe mollën ku do të krijohet mundësi e re për këtë sektor që të tejkalohen rreziqet e motit përmes sigurimeve bujqësore. Ne si Shoqatë e Sigurimeve do të vazhdojmë të jemi pranë kompanive të sigurimeve dhe fermerëve për t'i avancuar tutje produktet e sigurimeve bujqësore dhe për të krijuar produkte të reja të interesit në bashkëpunim edhe me MBPZHR-

në", u shpreh Mazreku. Sipas tij, krijimi i sistemit të sigurimeve bujqësore do ta ndihmojë sektorin e sigurimeve për t'i zhvilluar kapacitetet e tyre, për ta rritur tregun e sigurimeve, për të qenë më konkurrues në rajon, për t'i diversifikuar portofolat e tyre dhe për të generuar më shumë të ardhura, duke kontribuar kështu drejtpërdrejt në buxhetin e vendit.

Kompania e Sigurimeve "Elsig" mori përsipër shitjen e polisave të para të sigurimit bujqësor për kulturat bujqësore. "Ne e shohim tregun e sigurimeve bujqësore si një mundësi për zgjerimin dhe diversifikimin e portofolit tonë ekzistues, ndërsa për fermerët është një mundësi për t'i siguruar dhe zbutur rreziqet e tyre. Unë besoj fuqimisht se këto produkte të reja do të ndikojnë në zhvillimin e mëtutjeshëm të sektorit të sigurimeve në përgjithësi në Kosovë pasi na mungon nëse i krahasojmë me rajonin", ka deklaruar Ibrahim Isufaj, drejtor i Departamentit të Shitjes në Kompaninë e Sigurimeve "Elsig". Xhavit Kozhani është fermeri i parë në vend që bleu polis të sigurimit

bujqësor dhe u kompensua për humbjet e pësuar në pemishten e tij.

Në vitin 2016 dhe 2017 bujqësia e Kosovës humbi rreth 15 milionë euro nga dëmet si pasojë e ngjarjeve të lidhura me motin. Viti 2019 shënon një vit të rëndësishëm, pasi për herë të parë fermerët kishin mundësinë për t'i siguruar kulturat bujqësore përmes sistemit të ndërtuar të sigurimeve bujqësore dhe të jenë në gjendje t'i zbusin rreziqet nga moti dhe t'i mbrojnë investimet e tyre.

Për fazën e pilotimit, prodhuesit e mjedrës ishin "pionierët" për blerjen e polisave të sigurimeve për pemishten e tyre, ndërsa kompania e sigurimeve "Elsig" mori përsipër shitjen e polisave të para të sigurimit për kulturat bujqësore. Kjo ishte një bazë e mirë për ta testuar sistemin tashmë të krijuar të sigurimeve bujqësore.

Për ta lehtësuar më tej këtë proces, MBPZHR-ja subvencionoi për herë të parë preminë e sigurimit për produktin e mjedrës në kuadër të Programit të Zhvillimit Rural 2019, duke prezantuar skemën e subvencioneve, e cila mbulon pesëdhjetë për qind (50 për qind) të kostos së polisës së sigurimit për të gjithë fermerët që kanë blerë dhe do ta blejnë sigurimin bujqësor.

Në këtë fazë pilotuese janë trembëdhjetë polisa të shitura që mbulojnë rrezikun ndaj temperaturave të larta - prej 29°C dhe më lart, për dhjetë ditë radhazi. Meqenëse kjo verë u shoqërua me temperatura të larta, në disa lokacione rezultoi në prekjën e kufijve minimalë të përcaktuar të rrezikut. Me këtë rast, katër fermerë që kishin blerë polisë sigurimesh në këto rajone do të marrin pagesa dëmshpërblimi për humbjet në pemishte.

OAK-u fillon aktivitetin 'Kafja e Mëngjesit'

PRISHTINË, 26 SHTATOR (ER) - Aktivitetin e saj më të ri Oda e Afarizmit e Kosovës (OAK) e ka filluar në Radavc të Pejës me bizneset e këtij regjioni, e për qëllim kryesor kishte rrjetëzimin e bizneseve dhe informimin e tyre lidhur me propozimet që OAK ka përgatitur për Qeverinë e ardhshme. Kryetari i Bordit i Odës së Afarizmit të Kosovës, Skënder Krasniqi, falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen në këtë aktivitet, duke shtuar se ky është takimi i parë i këtij lloji e që do të vazhdojë edhe në javët në vijim edhe në regionet e

tjera të Kosovës. Sipas Krasniqit, Oda e Afarizmit të Kosovës është e interesuar që t'u qëndrojë afër bizneseve për tejkallim të sfidave të tyre, andaj përmes takimeve të tilla vazhdimisht informohen për së afërmi me sfidat në mënyrë që t'i identifikojnë alternativat për zgjidhje.

Kryetari Krasniqi fillimisht shpali para të pranishmëve propozimet që OAK i ka përgatitur për Qeverinë e ardhshme. Ndër të tjera, u theksua edhe nënshkrimi i marrëveshjes së MSA-së dhe CEFTA pa mbrojtje të asnjë produkti vendor, e që

konsiderohet se vetëm po favorizojnë importin dhe jo prodhimin vendor.

Gjatë këtij aktiviteti bizneset kishin rastin t'i prezantojnë problemet dhe idetë e tyre ashtu që bashkërisht të shtyhen para këto kërkesa. Ndër çështjet e theksuara nga bizneset ishin: ndikimi i taksës 100 për qind te bizneset, rëndësia e aftësisë profesionale dhe hapja e vendeve të reja të punës, liri i lëndës së parë, problemet me ATK dhe Dogana. "Kafja e Mëngjesit" rrugëtimin e vazhdon me bizneset e rajonit të Prizrenit.



Prizrenit së shpejti do t'i shtohet një produkt i ri turistik

PRIZREN, 26 SHTATOR (ER) - Komuna e Prizrenit ka bërë me dije se kësaj komune së shpejti do t'i shtohet edhe një produkt i ri turistik që i përket turizmit malor dhe aventurier. Kjo komunë ka theksuar se punimet për ndërtimin e shtegut "Via Ferrata" kanë hyrë në fazën përfundimtare dhe

projekti pritet të jetë i gatshëm gjatë muajit tetor të këtij viti. "Deri më tani kanë përfunduar punimet në rreth 300 metra, nga i gjithë shtegu që është paraparë të jetë me gjatësi deri në 500 metra. Përveç shtegut të "Via Ferrata" për ngjitje malore, parashihet edhe ndërtimi i urës tibetiane mbi Lumin e

Lumbardhit që mundëson qasjen nga rruga për në shteg. Ky projekt po realizohet në partneritet mes në të Komunës së Prizrenit, PPSE Program Swisscontact dhe ShB 'Sharri', si dhe në bashkëpunim me Klubin e Ngjitjes 'Marimangat', është thënë në njoftimin e Komunës së Prizrenit.



Lladrovci bën homazhe dhe përkujton dëshmorët dhe martirët e Abrisë së Epërme

DRENAS, 26 SHTATOR (ER) - Me rastin e përkujtimit të 21-vjetorit të rënies së tre dëshmorëve Valdet Xhemajli, Vesel Demaku dhe Afrim Hajdari, si dhe 29 martirëve, anëtarë të familjes Deliu, kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, nënkryetari Nazmi Hasi dhe drejtorë të drej-

torive komunale, anëtarë të Kuvendit të Komunës dhe stafin komunal, kanë bërë homazhe të enjten në fshatin Abri të Epërme, ku kanë vënë buqeta me lule dhe mbjell fidanë pishash në shenjë respekti për të rënë. Më 26 shtator të vitit 1998 forcat serbe kryen një rëndë prej masakrave më të

rënda të luftës, atë mbi familjen Deliu në fshatin Abri të Drenasit, në të cilën nuk u kursyen as foshnjat, as gratë dhe as të moshuarit. Drejtësia ende nuk ka vepruar për t'i ndëshkuar planifikuesit dhe ekzekutuesit e kësaj masakre dhe masakrave të tjera në Komunën e Drenasit.

Fillon rregullimi i rrugës në fshatin Bardh i Malishevës

MALISHEVË, 26 SHTATOR (ER) - Në kuadër të realizimit të projekteve kapitale në Komunën e Malishevës për vitin 2019 dhe në kuadër të rregullimit të infrastrukturës rrugore në të gjitha vendbanimet, në fshatin Bardh ka filluar hapja dhe rregullimi edhe i rreth dy kilometrave rrugë, ku përfshihen rruga për në shkollë dhe rrugët në disa lagje të fshatit.

Fillimin e punimeve në rrugët e fshatit Bardh e ka parë nga afër edhe nënkryetari i Komunës së Malishevës, Hajdin Berisha, i cili është takuar edhe me banorët e fshatit dhe i ka uruar për rregullimin e rrugëve. "Ne jemi duke i realizuar të gjitha planifikimet për

këtë vit dhe në kuadër të këtyre planifikimeve janë rreth dy kilometra rrugë në fshatin tuaj por, mbi të gjitha, është duke u rregulluar edhe rruga e shkollës e cila pritet të hapet nga java e ardhshme", ka thënë Berisha, duke shtuar se përmes projekteve konkrete janë duke u munduar ta lehtësojnë jetesën e malishevasve.

Ndërsa banorët e fshatit Bardh janë shprehur të kënaqur me fillimin e punimeve në rrugët e tyre, pasi lëvizja me automjete është mjaft e vështirësuar, sidomos kur fillojnë shirat dhe bora për shkak të konfigurimit të terrenit në fshatin e tyre.



Kastrati merr pjesë në seancën e parë të Forumit të Akademisë për Rininë

KAMENICË, 26 SHTATOR (ER) - Kryetari i Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, ka marrë pjesë në seancën plenare të edicionit të parë të Forumit të Akademisë për Rininë. Kjo seancë është organizuar nga misioni i OSBE-së në

Kosovë me temën "Arritja e barazisë gjinore, roli i rinisë". Punimet e kësaj seance i ka hapur kryetari Kastrati, i cili ka thënë se është shumë i lumtur që Kamenica është komunë model në barazi gjinore dhe përfshirje të

të rinjve në vendimarrje. "Lëvizja e grave për barazi dhe e të rinjve për përfaqësim, duhet të bashkohen për të krijuar partner-ship që imponon agjendën e elitës politike në vend", ka thënë Kastrati.



Suhareka voton buxhetin komunal për vitin 2020

SUHAREKË, 26 SHTATOR - Kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, përmes një postimi në rrjetin social "Facebook" ka bërë me dije se Kuvendi

Komunal i Suharekës ka votuar buxhetin komunal për vitin 2020. "Kuvendi Komunal i Suharekës, në mbledhjen e jashtëzakonshme që u mbajt

sot, ka votuar buxhetin komunal për vitin 2020. I falënderoj të gjithë asamblistët për bashkëpunimin, vërejtjet dhe sugjerimet. Unë do të jem

bashkëpunues dhe i hapur për zbatimin dhe menaxhimin e buxhetit të qytetarëve konform ligjit dhe rregullave", ka shkruar Muharremaj.



Aktuale / PDK-ja në koalicion me ligjin e me sovranin për t'i eliminuar shpërdorimet (3)

Mashtrulesit e shtetit mbrohen nga qeveritarët e lartë

Qeveria, me kryeministër Kadri Veselin, nuk do t'i lejojë më punësimet pa kritere ligjore dhe mbi bazën e ndërhyrjeve korruptive, politike, fafesisnore, familjare, partiake etj. Ky shpërdorim eklatant ka marrë shtrirje të gjerë, sidomos në vitet e fundit



Hasan MUJAJ

Ky status (i veteranit) u ble nga dy mijë e tre mijë euro me anë të nënshkrimeve fals të ushtarakëve, të ministrave etj. dhe tani veteranët mashtrules që i kushtojnë shtetit me miliona euro në vit, mbrohen nga qeveritarët e lartë sepse janë pjesëmarrës në mashtrim të shtetit dhe për këtë janë paguar mirë! Pra, Qeveria qendrore i mbështet veprat penale! Skandal i paprecedent!

Për këtë skandal të drejtësisë, që tumiret nga qeveritarët, ditë më parë, pati kritika të themelta edhe nga ambasadori i Zvicrës në Prishtinë, të cilat (kritika) u përsëritën edhe nga diplomatët të tjerë, por, diplomati i shtetit mik, për kritikën e bëra, u kërcënua me dëbim nga vendi nga një ministër! Kjo do të thotë se ministri nuk do ligjshmëri, por anarki dhe kështu e mbron korrupsionin! Me të gjitha këto veprimtari kriminale duhet të njoftohen qytetarët dhe të veprohet që, në forma të ndryshme e të organizuara mirë, të ngrihet kultura politike, demokratike, qytetare, kushtetuese etj. e sovranit që në zgjedhjet e ardhme të mos votohen më:

ata, të cilët ose ato, të cilat i kërcënojnë edhe diplomatët e shteteve mike me largim nga vendi vetëm se e thonë të vërtetën rreth aferave të mëdha korruptive siç është rasti i veteranëve manipulues në të cilin morën pjesë edhe qeveritarët të lartë të shtetit, deputetë e ndërmjetës të tjerë; ata, të cilët, posa erdhën në qeverisje, ia shtuan pagat vetes 100%; ata, të cilët paradite detyrohen të shkojnë në gjykata si të akuzuar për vepra penale, kurse pasdite shkojnë në kabinetet qeveritare dhe dalin në terren për t'iu folur qytetarëve për zbatimin e ligjshmërisë dhe për zhvillimin e shtetit; ata, të cilët ose ato, të cilat e shiten votën për t'i bërë numrat e votimit të Qeverisë në Parlament dhe që asnjëherë nuk diskutojnë për t'i parashtruar

problemet e jetës së qytetarëve që i përfaqësojnë në Kuvend, d. m. th. janë plotësisht indiferentë ndaj çështjeve relevante sociale, nacionale, shtetërore, ndërkombe-tare etj.; ata, të cilët ose ato, të cilat, edhe po të duan, nuk dinë të diskutojnë sepse u mungon kultura (kupto njohuritë) elementare nga retorika dhe gjuha standarde shqipe, d. m. th. nuk janë kultivues të vlerave kombëtare nga të cilat, kryesorja është gjuha standarde etj. M. F. Kuintiliani, edukatori dhe oratori virtuoz, për fjalimin publik, shkroi: "Fjalimi bazohet në ligjet e gjuhës". Më se e vërtetë.

Se gjuha standarde e një kombi, në përdorimin zyrtar, duhet të mbrohet me ligj siç veprohet në disa shtete, dëshmohej edhe nga mendimi i filozofit të shquar gjerman J. Habermas: "Gjuha nuk është pronë private". Ajo është vlera më e lartë kombëtare. Vetëm kështu, pra duke mos i votuar më ata, të cilët dhe ato, të cilat i hyjnë në mënyrë të lehtë e hipokritët që, për favorin e tyre materiale e politike, e shpuren shtetin në humnerë, porse duke i votuar ata që nuk kanë akuzë për veprat penale dhe që kanë zotësi për t'i përfaqësuar e arsytuar kërkesat e drejta të qytetarëve, mund të shënohet ndryshimi: ligji mbi të gjitha e për të gjithë dhe zhvillimi i ekonomisë së shtetit.

Retorika politike në Kosovë është në shkallë shumë të ulët sa u takon përbërësve të ndërtimit të saj. Po qe se ndiqen fjalimet politike të liderëve partiakë, të ministrave, të deputetëve etj. do të mund të vihet re mungesa e madhe, shumë e madhe e formimit retorik. Prandaj, mund të thuhet me të drejtë se ata (liderë, deputetë, ministra etj.) gabimisht kanë hyrë në politikë sepse nuk kanë përgatitje as teorike, as praktike nga retorika politike, as nga politolinguistika, as nga shkencat e tjera të komunikimit. Kanë hyrë në politikë jo se kanë themel përgatitjeje për të dhënë kontribut në këtë fushë të rëndësishme të veprimtarisë publike, porse kanë hyrë nga fakti për të arritur ndonjë përfitim ose poste të larta politike, nga fakti se politikën e shohin si biznes pasurimi e shpërdorimi!

Dituria nga retorika politike është

mjeti kryesor i zhvillimit të veprimtarisë së oratorit pa të cilin (mjet) nuk mund të jetë efektiv në rolin e politikanit të suksesshëm. Pasi është kështu, pra, pasi shumë politikanëve u mungon ky mjet (kultura retorike), është plotësisht e qartë se nuk mund ta kryejnë si duhet obligimin ndaj qytetarëve, ndaj votuesve e ndaj institucioneve të shtetit sepse nuk dinë ta shprehin në fjalim, në diskutim, në debat e forma të tjera të komunikimit publik as atë që e mendojnë. Prandaj s'është habi që politikanët e këtyrë, pa njohuri retorike, ndjekin dy rrugë: 1. kush të përpiqet të flasë e të bjerë komik në publik nga deficitet retorik dhe të kalojë në grindje e fyerje vulgare sepse është shumë i varfër sa i takon leksikologjisë së fjalorit politik; i kufizuar ngushtë sa u takon dijeve të tjera të shkencave të komunikimit; 2. kush të heshtë, vetëm të dëgjojë sepse detyrohet të jetë pasiv nga mungesa e forcës së fjalës dhe kulturës gjuhësore për ta shtënë atë (fjalën) në funksion tekstëzimi të komunikimit të fjalimit publik. Fjala e përkorë është forcë e politikës-shkroi një dijetar!

Përkritazi me këtë, prof. dr. Arshi Pipa me shumë arsye kishte shkruar: "Gjuha asht mjeti i shprehjes. Po të mos jetë mjeti i përsosur, asht e dijtun, vepra nuk del e mirë. Qysh mund të dali e bukur një shtatore kur dalta asht e paprehun". (Arshi Pipa, Kritika, Tiranë, 2006, f. 35). Me metafora të ekspresivitetit të lartë Pipa shpreh rëndësinë dhe vlerën e madhe që ka gjuha (dalta) për të ndërtuar tekstin (shtatoren).

Mirëpo, për zyrtarët e lartë të shtetit, të qenët pasiv në detyrën e besuar, nuk është shumë e rëndësishme. Relevante është të merret paga dhe të mos punohet! Oratorët e kësaj kategorie, duke mos pasur fond të mjaftueshëm fjalësh në ndërdije për të ndërtuar e modifikuar tekstin e fjalimit të mendimit politik, kalojnë në frazim, në gënjë e në konstatime fiktive, në sharje e madje edhe në sulme fizike ndaj njëri-tjetrit!

Është e kuptueshme se kudo ka njerëz mentalisht të sëmurë që mbahen nën mbikëqyrje shëruese psikiatrike, porse nuk është e kuptueshme të futen në lista votimi as të votohen kandidatët e këtij tipi. Habi e madhe! Shumë e madhe. Kur të mbahen parasysh këto raste, del në dritë fakti i rëndësishëm me të cilin duhet të merren strukturat drejtuese partiake, mediet, analistët dhe instancat e tjera; ai fakt është: ndikimi dhe edukimi

etik e vlerësues i votuesve për t'i votuar më të mirët, për të vlerësuar e analizuar se cili ka përgatitjen e duhur për të dhënë kontributin më të çmueshëm në zhvillimin e avancimin e proceseve të zhvillimit ekonomik e politik në favorin e përforsimit të institucioneve të shtetit të Kosovës. Ky edukim do të përforsohet edhe nga kriteri i përzgjedhjes së kandidatëve për t'i futur në listat e votimit të partive politike. KQZ-ja, tok me instanca të tjera, duhet ta shtrijë veprimin në forma të ndryshme edhe në terren për t'i orientuar e mësuar votuesit për anën teknike të votimit nga fakti se në zgjedhjet parlamentare të njëmbëdhjetë qershorit 2017 pati me mijëra fletëvotime të pavlefshme.

Votimi, obligim kushtetues

Votimi është obligim ligjor, është obligim kushtetues, demokratik, etik dhe shtetëror. Ai është akt vendimtar për të formuar institucione legjitime që burojnë nga vullneti i lirë i qytetarëve për ta drejtuar dhe për ta zhvilluar shtetin me arritje risimtare. Pikërisht për këtë arsye në shtetet më të zhvilluara dhe me demokraci të mirëfilltë, këtij procesi (votimit) i kushtohet vëmendje e posaçme nga institucionet përkatëse, por edhe nga qytetarët dhe zyrtarët kompetentë të vendit.

Vendin parësor në garën parazgjedhore e zgjedhore të shteteve me traditë të gjatë demokratike e zënë temat që kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik të shtetit, me projekte të realizueshme që të ngrihet standardi i jetës së qytetarëve, që të hapen vende të reja të punës etj.

Në Kosovë shumë pak ndiqet kjo ecuri. Në fjalimet e disa liderëve të partive politike mbizotërojnë akuzat, shpeshherë edhe të trilluara, të votohet lideri dhe partia politike që dëshmuar me shembuj. Por, në Kosovë, në fushatën parazgjedhore, sikundër mund të shihet nga praktika, vendin qendror në fjalimet e disa liderëve dhe të poltronëve të tyre nuk e kanë projektet me interes për mirëqenien e qytetarëve, porse mbizotëron propaganda me premtimet shterpë, me akuzat dhe etiketimet për oponentët politikë, shpeshherë edhe me shpifje e trillime të ndryshme, me fjalime panegjirikë që u referohen liderëve të partive politike edhe pse pa ndonjë meritë avancimesh të reja etj. Kjo veprimtari quhet demagogji. Por, dështimet dhe shpërdorimet e

mëdha të qeveritarëve nuk duhet t'i harrojnë qytetarët që po i pësojnë rrjedhojat stagnuese dhe reflekset e tyre në varfërinë gjithnjë e më të madhe të jetës së tyre. Në shtetet me demokraci të zhvilluar dhe të stabilizuara, shpagimi i dukurive të këtyrë antiligjore, sanksionohet edhe me votat e qytetarëve. Tani është koha që kështu të veprohet edhe në Kosovë.

Votimi nuk është veprim i lehtë. Ai kërkon njohje, meditim, analiza dhe vlerësim; ai kërkon angazhim të thukët për të gjitha shtresat e shoqërisë në mënyrë që të ngrihet kultura demokratike, e cila do të zhvillonte vetëdijen se duhet të çmohet dhe të votohet vlera, të votohet flijimi e kontributi për lirinë e pavarësinë e Kosovës, për shtetin sovran etj.

Shteti duhet të vihet mbi interesin privat të secilit. Ky është kriteri i demokracisë, përfillja e të cilit nuk do të lejonte që të vërshojnë shpërdorimet e ndryshme dhe veprimet anarkike; për këtë është më se i mbëshihshëm edukimi demokratik që të mos gjejnë terren shtrirjeje dukuritë negative si: korrupsioni, nepotizmi, antivlera, interesi, përfitimi personal etj. Dhe, përderisa nuk luftohen këto dukuri, s'është habi që në institucionet e larta të shtetit do të emërohen njerëz të paafhtë, se do të propozohen e do të votohen për deputetë njerëz që nuk dinë të flasin as të shkruajnë si duhet në gjuhën amtare madje kanë vështirësi të mëdha për ta gjuhëzuar mendimin, se votohen njerëz me të kaluar të dyshimtë politike, se lejohet e mundësohet të futen në politikë njerëz pa kapital elementar politik, etik retorik, sociokulturor, demokratik etj.

Dhe, qytetari ynë i voton njerëzit e këtyrë sepse voton sipas sugjerimeve të të tjerëve, voton pa e ditur rëndësinë e votimit dhe pa e vlerësuar kandidatin; për ta votuar dikë, duhet ta vlerësosh lart të kaluarën dhe të sotmen e tij, biografinë dhe kontributin e deritashëm të tij etj. Vota duhet të jetë autonome, e lirë dhe pa ndërhyrje. Kjo është e drejtë ligjore. Kjo duhet t'u bëhet e qartë të gjithë qytetarëve.

Fjalimet në tubimet parazgjedhore duhet të karakterizohen nga retorika pozitive, nga respekti reciprok i liderëve politikë, nga fjalori selektiv, kulturor, estetik dhe etik. Ato duhet të jenë në përpjesëtim me realitetin e të zbatueshme në praktikë dhe jo premtime utopike e iluzore, romantike e euforike hiperbolash manipuluese.

(Fund)

Vdes ish-presidenti francez Zhak Shirak



Në moshën 86-vjeçare ka vdekur të enjten ish-presidenti i Francës, Jacques Chirac, i cili gjatë kohës së luftës në Kosovë iu bashkua shteteve të Perëndimit dhe kishte përkrahur vendimin për ta bombarduar Serbinë. Për vdekjen e ish-presidentit francez kanë ngushëlluar edhe liderët e Kosovës

PARIS, 26 SHTATOR - Franca po nderon ish-presidentin Zhak Shirak, një politikan veteran dhe mbështetës i multilateralizmit, bashkimit të Evropës dhe Afrikës, i cili vdiq të enjten në moshën 86-vjeçare.

Në moshën 86-vjeçare ka vdekur të enjten ish-presidenti i Francës, Jacques Chirac. Ligjvënësit francezë mbajtën një minutë heshtje, ndërsa gjatë ditës me një fjalim drejtuar kombit u paraqit presidenti Emmanuel Macron.

Zhak Shirak i takonte gjeneratës së vjetër të politikaneve, kryetar i Bashkisë së Parisit për 18 vjet, përpara se të bëhej kryeministër e më vonë president për më shumë se një dekadë. Ai do të mbahet mend për shumë gjëra, përfshirë të qenit kreu

i parë i shtetit francez që pranoi rolin e vendit në Holokaust gjatë një fjali mi të vitit 1985.

Shirak do të mbahet mend edhe për kundërshtimin e ndërhyrjes në Irak të udhëhequr nga ShBA-ja në vitin 2003, ka njoftuar voa. Ai njihet si një mbështetës i vendosur i Afrikës. Zhak Shirak ishte mik i ngushtë me disa udhëheqës afrikanë, përfshirë Omar Bongo të Gabonit, Blaise Compaore të Burkina Fasos dhe Denis Sassou Nguesso të Republikës së Kongos.

Zhak Shirak themeloi muzeun "Quily Branly", një vitrinë e artit afrikan, së bashku me Oqeaninë dhe kontinentin amerikan. Në vitin 2016 muzeut iu bashkëngjit edhe emri i tij duke u quajtur "Quai

Branly - Zhak Shirak". Megjithatë, kritikët thonë se lidhje të tilla nënvizojnë ndikimin e vazhdueshëm të Francës tek ish-kolonitë e saj.

Në Francë qëndrimet ndaj tij ishin të përziera. Në një proces zgjedhor tronditës në vitin 2002, ai e gjeti veten në balotazh me udhëheqësin e ekstremit të djathtë Jean-Marie Le Pen, duke fituar më pas me lehtësi në atë që shumë e quajten një votë kundër ekstremizmit. Por ai nuk arriti ta rindërtojë ekonominë apo t'i adresojë në mënyrë të qëndrueshme problemet e të rinjve që vinin nga familje emigrantësh e të zhveshur nga të drejta të tyre ligjore, një situatë që shpërtheu në 2005-n. Por ai e rifitoi popullaritetin pas largimit nga pushteti në 2007-n, madje edhe pse disa nga akuzat ndër vite ndaj tij për korrupsion e çuan përpara gjykatës. Megjithatë, shumë e mbajnë mend Zhak Shirakun për shamin dhe aftësinë për t'i bërë për vete njerëzit e thjeshtë, një njeri i kujdesshëm si me diplomatët, po ashtu edhe me fermerët.

Shiraku, në krah të Kosovës në ditët e saj më të vështira

Në kohën e luftës në Kosovë, Chirac mbështeti shtetet e Perëndimit dhe kishte përkrahur vendimin për ta bombarduar Serbinë. Edhe liderët e Kosovës kanë ngushëlluar për vdekjen e ish-presidentit francez. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka shkruar se ish-presidenti i Francës kishte qenë në krah të Kosovës në ditët e saj më të vështira. Ai ka kujtuar përkrahjen që kishte bërë Chirac në kohën kur ishte vendosur për bombardimin e caqeve të Policisë dhe të Ushtrisë serbe në vitin 1999. Kosova, ka thënë Thaçi, do të jetë gjithnjë mirënjohëse ndaj tij. "Me keqardhje të madhe mora lajmin për vdekjen e ish-presidentit të Francës, Jacques Chirac. Ai ishte një prej figurave të mëdha të politikës botërore që i doli në ndihmë Kosovës në ditët më të vështira, sidomos në Konferencën e Rambujesë dhe përkrahjen për bombardimin e caqeve të policisë

dhe ushtrisë serbe në vitin 1999. Jacques Chirac do të mbetet një burrështetas i respektuar dhe emër për të cilin qytetarët e Kosovës do të jenë përjetësisht mirënjohës", ka shkruar Thaçi.

Kryeministri në detyrë i Kosovës, Ramush Haradinaj, në "Facebook" ka shkruar se ndihma e Chiracut ndaj Kosovës në kohën e luftës kishte parandaluar gjenocidin dhe eksodin e popullit të Kosovës. "Me keqardhje mësova lajmin për vdekjen e ish-presidentit francez Jacques Chirac. Kosova do të kujtojë gjithmonë ish-presidentin Chirac si një përkrahës i fuqishëm i vlerave të lirisë dhe jetës, në këtë frymë edhe vendimin për mbështetjen e fuqishme të Republikës së Francës për ta ndaluar gjenocidin dhe eksodin e popullit të Kosovës në vitin 1999, për intervenimin e NATO-s kundër agresorit serb udhëhequr nga Millosheviqi. Në emër të popullit të Kosovës i shpreh ngushëllime popullit të Francës dhe familjes së ish-presidentit Chirac", ka shkruar Haradinaj.

Presidenti mandaton Netanjahun ta formojë qeverinë

TEL-AVIV, 26 SHTATOR - Presidenti i Izraelit i ka kërkuar kryeministrit Benjamin Netanjahu që t'i nisë përpjekjet për formimin e një qeverie të re në kushtet kur asnjë forcë politike nuk ka fituar shumicën e nevojshme për ta formuar qeverinë, situatë që ka paralizuar vendin.

Zyra e presidentit Reuven Rivlin e bëri njoftimin të mërkurën pas takimit me Netanjahun dhe kundërshtarin e tij kryesor, Benny Gantz.

Në Izrael presidenti gëzon të

drejtën ta zgjedhë kandidatin që ai beson se ka mundësinë më të mirë për të formuar një qeveri koalicioni në kushtet kur as partia e Netanyahu dhe as ajo e Gantzit nuk morën mbështetjen e duhur për ta formuar qeverinë.

Rivlin ndërmjetësoi dy takime këtë javë me shpresën për arrijtjen e një marrëveshje në mes të Partisë Konservatore Likud të Netanjahut dhe partisë së qendrës së Gatz Aleanca Bardhë e Blu. Bisedimet u mbyllën për shkak të mosmarrëveshjeve se

kush do ta drejtojë qeverinë e mundshme të unitetit. Gantz ka thënë se ai nuk do të bëhet pjesë e një qeverie të udhëhequr nga Netanjahu për shkak të problemeve të tij ligjore.

Kryeministri Netanjahu po kërkon me dëshpërim të mbetet kryeministër në mesin e një hetimi ndaj tij për korrupsion. Prokurori i përgjithshëm i vendit ka rekomanduar ngritjen e akuzave për mashtrim, ryshfet e shkelje të besimit ndaj Netanjahut, akuzat që rrjedhin



nga një numër skandalesh. Netanyahu, i cili mohon çdo shkelje, pritet të paraqitet përpara

prokurorit të përgjithshëm javën e ardhshme, pas së cilës pritet një vendim lidhur me akuzat.



AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperiencia jonë
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333

E jashtëzakonshme

Shefi i rrit pagën minimale punonjësve në 70.000 dollarë në vit

Një shef që uli pagën e vet për t'ia rritur punonjësve të tij katër vite më parë, tani po e bën sërish. Dan Price, kreu i Gravity Payments me bazë në Seattle ka bërë me dije se të gjithë të punësuarit në kompaninë e tij e re Boise në Idaho do të fitojnë një



pagë minimale vjetore prej 70.000 dollarë deri në vitin 2024. "Ne premë shiritin e zyrës së re të Gravity Payments dhe njoftuam se punonjësit do fitojnë minimalisht 70 mijë dollarë në vit", ka shkruar Price në "Twitter".

FOTO E DITES



Shtëpitë pranë lumit Ganges në Prayagraj në Indi përmbyten nga shirërat e mëdha /AP/

E rrallë

Alarm i kuq në "planetin blu"!

Ndryshimet klimaterike po shkatërrojnë detet dhe zonat e ngrira si kurrë më parë, paralajmëron një raport i ri i Kombeve të Bashkuara. Sipas një paneli shkencëtarësh, niveli i ujërave po rritet, akulli po shkrin, dhe shumë specie

po ndërrojnë habitat për shkak të aktiviteteve njerëzore në tokë (i njohur ndryshe si planeti blu prej sipërfaqes së madhe me ujë). Ata thonë se humbja e përhershme e tokave



të ngrira kërcënon çlirimin e një sasive më të madhe karboni, duke përshpejtuar dobësimin e tyre.

BARSOLETA E DITËS



- Mami, mami, shokët tallen me mua. Më thonë se kam këmbë shumë të mëdha.
- Bëjnë shaka, shpirti i mamit, mos ua vër re! Hajt tash, shko parkoju këpucët në garazh se do të hamë drekë.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Çdo ditë në ora 16:00 Toy Story 4 / 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi;
1 orë 40 min

Rolet: Tom Hanks (Woody), Annie Potts (Bo Peep), Tim Allen (Buzz Lightyear), Tony Hale (Forky), Keegan-Michael Key (Ducky), Madeleine McGraw (Bonnie), Christina Hendricks (Gabby Gabby), Don Rickles (Mr. Potato Head), Jordan Peele (Bunny), Wallace Shawn (Rex), John Ratzenberger (Hamm), Keanu Reeves (Duke Caboom), etj.

Regjia: Josh Cooley



Në ora 18:00 dhe 20:00

AD ASTRA

Aventurë/Dramë/Mister; 2 orë 04 min

Rolet: Brad Pitt, Tommy Lee Jones, Ruth Negga, Liv Tyler, and Donald Sutherland

Regjia: James Gray




Çdo ditë në ora 22:00

DOWNTON ABBEY

Dramë; 2 orë 02 min

Rolet: Hugh Bonneville, Jim Carter, Michelle Dockery, Elizabeth McGovern, Maggie Smith, Imelda Staunton, Penelope Wilton, etj.

Regjia: Michael Engler



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: **Kino ABC**.



DASHI

Mos i mbani mendimet rreth një çështjeje të

caktuar vetëm për të parandaluar një konflikt të mundshëm. Shprehni opinionin tuaj pa hezituar, pasi rezultati mund të jetë krejtësisht ndryshe nga çfarë e mendoni.



DEMI

Do ta keni të vështirë të dalloni të vërtetën nga gënjeshtra.

Kjo nuk do t'ju ndihmojë aspak gjatë një interviste për punë apo gjatë një takimi biznesi. Kërkoni të vërtetën jo vetëm përmes fjalëve, por edhe përmes gjesteve.



BINJAKËT

Përpjekja për të ndihmuar dikë të jetë më i lumtur

është një ndërmarrje e vështirë dhe një rrezik i madh. Ndonjëherë ju thjesht duhet t'i lejoni njerëzit të jetojnë në mënyrën se si ata zgjedhin të jetojnë.



GAFORRJA

Ekziston mundësia që sot të mermi një përgjigje të

sinqertë rreth një çështjeje të caktuar, çfarë do t'ju fusë gjatë në mendime. Megjithatë, pranojeni të vërtetën ashtu sikurse është dhe mos lejoni që të mbizotërojë egoja.



LUANI

Dikush pranë jush po përballlet me

konfuzion. Ju mund të dëshironi të ndihmoni në zgjidhjen e dilemës së këtij personi, por kontributi juaj mund të shihet si me dyshim.



VI RGJËRESHA

Kënaquni më shumë me muzikën dhe me artin

sot. Arti vizual do të stimulojë edhe mendjen tuaj, kështu që bëni ndonjë vizitë në një muze apo në një galeri arti.



PESHORJA

Dita e sotme do të kalojë sikur të ishte një moment i

vetëm. Përpiqui ta kaloni ditën në paqe dhe në qetësi. Mos ia shfaqni botën tuaj të brendshme njerëzve rreth jush.



AKREPI

Disa Akrepa do të çlirohen nga ankthet afatgjata. Në

marrëdhënien tuaj romantike mungon energjia. Në jetën profesionale, përpiqui që disa detyra t'ia kaloni dikujt tjetër, pasi jeni tejet të ngarkuar.



SHIGJETARI

Shfaqja e dikujt pas një kohë të gjatë apo kujtimi i një

ngjarjeje të pakëndshme në të kaluarën do të sjellë situatë të tensionuar sot. Për ta kaluar më lehtë shpenzoni më tepër kohë me familjarët tuaj apo personat që ju i besoni.



BRICJAPI

Këtë të diel bricjapët do të kenë nevojë për

ndihmën apo këshillën e dikujt në lidhje me çështjet financiare. Beqarët e kësaj shenje do të kenë sukses në lidhje me seksin e kundërt.



UJORI

Disa persona të kësaj shenje do të përjetojnë

disa momente të vështira. Një nga arsyet për këtë mund të jetë një debat në mëngjes me partnerin/partneren.



PESHQIT

Sot do të tregoni fuqinë tuaj më të madhe.

Mund të bëni një plan strategjik për t'i shpëtuar krizës financiare. Sa i përket aspektit personal, gjërat nuk do të shkojnë siç duhet. Ndërsa beqarët e kësaj shenje rrezikojnë të hapin një plagë të vjetër sot.

Martohet Cassie



Cassie dhe Alex Fine, janë zyrtarisht burrë dhe grua. Vetëm disa javë pasi njoftuan fejesën e tyre, këngëtarja 33-vjeçare dhe trajneri personal 26-vjeçar, kanë zbuluar se janë martuar. Prindërit e ardhshëm u kurorëzuan

në një ceremoni të vogël dhe intime në Malibu. Nuk dihet se kur saktësisht është zhvilluar ceremonia. Nëse nuk e dini, në muajin qershor Cassie dhe Alex njoftuan se ata po presin fëmijën e tyre të parë së bashku.

Justin Bieber dhe Hailey Baldwin përgatiten për dasmën përrallore



Justin Bieber dhe Hailey Baldwin do të mbajnë ceremoninë e dytë martesore në fund të këtij muaji. Tani modelja po përgatitet për dasmën. Një burim ka thënë për "ET" se 22-vjeçarja bëri një trajtim fytyrë për 75 minuta në Beverly

Hills në fillim të kësaj jave. Sipas burimit, trajtimi që modelja bëri i largoi nga trupi të gjithë lëkurën e vdekur si edhe i pastroi të gjitha toksinat. Hailey u shoqërua nga bashkëshorti Justin në SPA, por këngëtari vetë nuk bëri trajtime.



Kylie Jenner shtrihet në spital

Raportohet se Kylie Jenner është shtruar në spital dhe sipas burimeve ajo kishte 'simptoma të ngjashme me gripin'. 22-vjeçarja u kontrollua në një spital të zonës në Los Angeles.

Simptomat ishin vjellje dhe marramendje. Aktualisht, nëna e Kyliet, Kriss është në Paris për Javën e Modës, ndërsa prindi i saj Caitlyn Jenner është pranë saj në spital. Nuk dihet ende gjendja e saj.

Arrestohet edhe një person në lidhje me vdekjen e Mac Millerit



Një person tjetër është arrestuar në lidhje me vdekjen e Mac Millerit. Reperi 26-vjeçar ndërroi jetë pas një mbidoze të drogës në shtatorin e vitit të kaluar dhe deri më tani, një person është arrestuar për furnizimin me tableta të falsi-

fikuara që përmbanin fentanyl. Tani një 36-vjeçar me emrin Ryan Reavis u arrestua nën akuzën e skemave mashtruese si dhe shitës i drogës, mbajtës i ilaçeve pa recetë dhe armë pa leje. Detajet në lidhje me marrëdhëniet e të dyshuarit me Mac nuk janë bërë publike ende.

Poezia e Palit, një dramë poetike kombëtare dhe familjare

Arben PRENDI

Autori Pal Ndrecaj vjen me vëllimin më të ri poetik Nën galaktikën që e ke krijuar vetë. Ky vëllim përbëhet nga këta pesë cikle: Art poetik, Tablo me atdhe, Dritat, Nën galaktikën që e ke krijuar vetë dhe Imazhe. Këta cikle janë shprehje e gjendjeve reale dhe metafizike të poetit në kohën në të cilën jeton. Por, le t'i analizojmë ato me radhë.

Manifesti poetik

Në ciklin e parë Art poetik artikullohet kredoja poetike e krijuesit në aventurën e tij të përhershme për të kërkuar dhe realizuar mjeshtërinë artistike, poetike. Në këtë aventurë janë poeti, lexuesi, kritika, por edhe bota tjetër që është përgjithësisht indiferente ndaj artit. Këto poezi në thelb janë poezi për poezinë dhe na paraqesin konceptin poetik të autorit: çfarë është për të poezia, vargu, forma, domethëniet kuptimore, qëllimi i saj etj. Është e njohur se artisti krijon botë, duke imituar Zotin, përkatësisht ky është universi ku jeton poeti: galaktika që ka krijuar është arti i tij, atdheu që e mbart me vete dhe imazhet ku përthihen të gjitha këto.

Secila poezi ndërtohet mbi artikullimin e një esence kuptimore. Poezia diku na del si mundim, torturë, kërkim dhe mision vetësakrificues i krijuesit:

*Nesër do të ngushëllohem
se ishin fluturime të rastësishme
që provokojnë para kohe
dhe se është e zakonshme me u sjellë
edhe nëse ke me u djegë në fund.
(Poezi për një flutur dhe për një ide...)*

Ndërsa në poezinë Për fund poeti është shpallësi i të vërtetës dhe, si i tillë, nuk mund të fajësohet:

*Po nëse lumi e solli këtu tërë këtë llum
ç'faj kam unë që e thashë...*

Gjeografia metafizike e atdheut

Në ciklin Tablo me atdhe autori ndjek një motiv të njohur në poezinë shqipe, veçmas në poezinë shqipe në Kosovë, duke konfiguruar poetikisht tablotë që përbëjnë gjeografinë metafizike të atdheut. Përmes një toni narrativ që përshkon pothuajse të gjitha poezitë e këtij vëllimi, atdheu mitizohet dhe antropomorfizohet poetikisht, por nëpërmjet një përjetimi dhe ndjeshmërie moderne që lind nga reflektimi i njeriut bashkëkohor të shkëputur nga vendi i tij dhe jo nga patetizmi e retorizmi romantik i tejkualuar.

Në këtë cikël artikullohen trajtat e mbartjes së atdheut me vete si dhimbje e kryqëzimit të tij (Tablo me atdheun në javën e madhe), si kujtim i vendlindjes (Në shtëpinë e lindjes në Moglicë, Nata në Moglicë), kujtim i të afërmeve dhe i njerëzve të dashur (Kangë Krishtlindjesh, Gjyshja) kujtim e aktualizim i figurave kulturore si: Ali Podrimja, Xajë Nura, Latif Berisha; nderim dhe ndërtim i historisë që nga ilirët (Teuta), Skënderbeu (Duke pritur Gjergjin me u kthye), arbëreshët (Bisedë me një arbëreshe), deri tek të rënë në luftën e fundit në Kosovë (Poezi rapsodike për mikun tim dëshmor Gaspër Karaqi).

Kredoja e këtij cikli artikullohet në poezinë Tablo me atdheun në javën e madhe, ku poeti njehon dramën e kryqëzimit të Krishtit me atë të atdheut të tij duke shpre-

suar njëkohësisht për ringjalljen e tij sikurse në legendën biblike të ringjalljes së Krishtit. Atdheu kalon mundimet e kryqëzimit gjatë gjithë javës, vdes të shtunën dhe ringjallet të Dielën e Pashkëve. Në këto imazhe përfshihet silueta e një figure femërore e cila, sikurse në legendën biblike, ngjason me siluetën e Maria Madalenës, e cila në rrëfjen biblike ia lan trupin Krishtit me aroma të mira. Madje në fund të kësaj poezie atdheu identifikohet edhe me vetë këtë siluetë femërore, e cila ngjan me të dashurën e poetit. Pra, atdheu identifikohet me njeriun, atdheu është njeriu, janë njerëzit tanë të dashur.

*Të dielën më shumë se kurrë
atdheu të përngjan Ty
Ai është trupit dhe shpirti Yt
që më mban në jetë*


Ky antropomorfizim i atdheut plotësohet me poezitë e tjera për prindërit, gjyshen, vendlindjen, djalin, miqtë, poetët, simbolet e historisë sonë kombëtare etj. Dramën e poetit në marrëdhënien me atdheun, por edhe mitizimin e ri të tij, e përmban edhe poezia Martini niset për Atdhe. Shqetësimi i poetit dhe prindit se brezi më i ri, i cili u largua në moshë të mitur nga atdheu drejt vendeve të tjera, do ta ketë të vështirë ta ripërtërijë lidhjen me atdheun edhe në një realitet kompleks ku koncepti për atdheun është duke ndryshuar me shpejtësi në botën kozmopolite:

*Ka dalë prej Kosove kur s'e dinte ç'do me
thanë atdhe
në Fordham University ka hasë në teorinë e
Atdheut planetar
të cilën e ka përqafuar si idenë më të mirë
për një botë humane
Në shtëpi i kemi thënë se tharmi më i mirë
për të
është dheu ku të ka shkelë këmba më së
pari*

Pra atdheu, sipas teorisë moderne është, si me thënë, planeti Tokë, gjithçka tjetër do të bëhet e parëndësishme.

Nën peshën e absurdit dhe të mëkatit të rrjedhshëm

Në ciklin Nën galaktikën që e ke krijuar vetë përmes këndvështrimit poetik të botës poeti e krijon galaktikën e vet. Kjo është galaktika e botës njerëzore, e cila ka planetët dhe yjet, që janë njeriu dhe njerëzimi, në fate të përbashkëta dhe individuale. Në mjaft prej poezive përsiatet mbi fatin e njerëzimit në shekullin modern dhe atë të individit si vete më vete, por edhe si pjesë e shoqërisë ku jeton. Vuajtjet e individit dhe njerëzimit vijnë nga veprimet apo mosveprimet e tij si dhe nga një përcaktim i fatit të tyre absurd, të ngjashëm me atë të Sizifit në esenë e njohur të shkrimtarit të njohur francez A. Kamy, heroit të ndëshkuar nga hyjnitë për të bërë një punë, në thelb absurde, por që për Kamynë mund të vishet me kuptim, madje mund edhe ta bëjë të lumtur heroin dhe njerëzimin. Madje në këtë cikël ndihet afria e poetit me filozofinë e absurdit, si një mënyrë për t'i dhënë kuptim ekzistencës dhe veprimet të njeriut në jetë. Kjo gjendje shprehet më qartë në poezinë Çka na thotë Sizifi kur rikthehet te guri:



*Edhe gjërat që nuk mund t'i ngremë në majë
vlejnë*

*qoftë vetëm për hir të përpjekjes
kështu pastaj ato marrin peshë
dhe nuk iu nënshtrihen ligjeve të gravitetit
tërheqin përpjetë
Me rënie të lirë bien vetë gjërat e lehta*

Këtu poeti e shfaq qëndrimin e vet të angazhimit në çështjet e botës, qëndrim i cili është i pakompromis duke ikur nga neutraliteti intelektualist dhe duke kërkuar rrugën e tij përmes mundimit të Sizifit i cili e bën betejën e tij pavarësisht prej fundit absurd.

*...prandaj nuk e kam zgjedhë mesin
kam zgjedhë me u rrëzue në ndonji skaj
por që është skaji im
që është maja ime deri ku jam ngritë tue
shtuar peshë
dhe duke mos ndigju me shkue mbas
tjetërkujt
as me u tërheqë me litar tri deri në pesë
metra
si makinat e prishura të mbetura në rrugë*

Edhe poezia Binarët duket se përshkohet nga gjendje të frymëzuara nga absurdi kamyzian: rruga e ekzistencës së njeriut kalon përmes gjendjesh absurde: fitore dhe humbje, ato i japin kuptim asaj, sikurse veprimet në dukje pa kuptim të Sizifit:

*Kështu mes fitoresh e humbjes,
udha jote mbërrin në fund
Në mbarim të betejës së pasosur
të dy flamujt njëllor tund*

Ndërkaq paralelisht me temën e absurdit të ekzistencës është e pranishme atmosfera e zymtë e një bote që vuan pasojat e mëkatit të rrjedhshëm sipas frymës së krishterë. Një botë e këtuillë është e mjegullt, e palumtur dhe e paorientuar mirë në hapësirë dhe në kohë. Vizioni se kjo palumturi dhe papërsosmëri buron nga shpirti i ndotur prej mëkatit të rrjedhshëm, të papastruar në kohën e duhur. Madje kjo gjendje e shpërkat poezinë me një pikëllimë të rëndë dhe në pamje të parë të pakuptueshme, por të përjetueshme. Qenia është e palumtur në një botë të kërcënuar nga arrijtet teknologjike të cilat kanë nxjerrë në rend të dytë arrijtet shpirtërore, të cilat domosdo e mbingarkojnë poetin edhe me një vizion apokaliptik të saj dhe pastaj në vënie të dyshim si në poezinë Demant mëkatit të rrjedhshëm apo në poezi të tjera të kësaj gjendjeje:

*... Në jetë kështu nuk udhëtohet
thonë ata që të gjitha caqet
i kanë gjet të gatshme si mëkatit e
rrjedhshëm
... Më beso më i mirë është një dyshim që
tmerrësisht të trazon
se besimi i dhuruar që ta falë qetësinë
që nuk ia shpalar rënjet asnjë fije bari*

Ndërkaq në poezinë Sprovë ngjan se "mëkati i rrjedhshëm" qëndron si diçka e trishtuar mbi gjithë galaktikën shpirtërore të poetit, madje rrezikon edhe ta shkatërrojë tërësisht:

*Diçka e trishtë
bredh nëpër galaktikën
që e ke krijuar vetë
herë si dritë
herë si kometë
... Veç druej se ka me e goditë
e ka me ta bërë copë-copë
atë planet*

Por në këtë botë absurde, të trishtuar e të errësuar nga mëkati i rrjedhshëm, shkëlqen njeriu i cili është si yjet, i rrethuar nga terri i tij, që zhvillon idenë e galaktikës së krijuar nga poeti:

*Në pëshëllakun e madh të territ
yjet janë dëshmia se terri mundet me u
shpërthye
janë rasti me të provokue mu tashti
e me të bërë mendue se edhe ti je si ata:
i mbeshëllë me terrin tand*

Kurse në poezinë Tufa e Zotit autori ironizon parabolën biblike të krijimit të njerëzimit derisa ai u shkëput nga bariu i tij:

*Pastaj dikush doli prej saj
e braktisi
tha se quhej Unë
... Sot e atë ditë
bariu e Uni nuk kanë më paqe
shëri i tufës së Zotit*

Poezitë e këtij cikli vijnë duke krijuar një vështrim filozofik mbi botën ku jetojmë dhe problemet që ka shoqëria moderne. Këtu zgjerohet vizioni prej demiurgu i poetit i cili merret me probleme e tema mbarënjëzore, duke nisur nga ato biblike me historinë e Adamit dhe Evës (Biseda e fundit mes Adamit dhe Evës) deri te përditshmëria e njeriut bashkëkohor përmes puthjes së Judës. Madje poeti ndërton edhe vizionin e fillimit dhe fundit të botës: Adami dhe Eva në fillim dhe fund në poezinë Për fundin. Fundi një herë është fundi i rrugëtimit të njeriut të vdekshëm, herë është fundi i qytetërimit: me foshnjën që nuk di të qeshë dhe me vajzën që ia mbyll sytë kukullës së saj që të mos shohë tmerret që prodhon qytetërimi modern apo me frikën nga bomba atomike.

Një pjesë e poezive, me sa duket, mbështeten në përjetimet e autorit përgjatë fluturimeve me avion dhe vetvetiu krijojnë imazhin e vështrimit në distancë dhe nga lart të botës dhe problemeve të saj (Luaj me glob..., E shkruar gjatë fluturimit..., Gjatë fluturimit, Duke fluturuar). Si të thuash, poeti qëndron lart dhe bota poshtë si një hartë e vizatuar prej tij, që përputhet me imazhin e "galaktikës që e ke krijuar vetë". Poeti luan me globin në fantazinë e tij, por i këshillon udhëheqësit e njerëzimit të mos sillen si poetë sepse tragjeditë që shkaktajnë veprimet e tyre nuk kanë fund. Shqetësimi për fatin e botës njerëzore dhe të njeriut e dominon poezinë e këtij cikli deri në atë masë sa mund ta quajmë autorin si poet të angazhuar, që reflekton për katastrofat që njerëzimi ia ka thurur vetes gjatë shekullit modern si në poezinë Rekuem për Murin e Berlinit:

*Çmendunia e një gjysmëshekulli
u copëtua në miliarda thërrmija
u shkull nga ekzistenca
siç e heqim nga vjersha
një varg që nuk shkon*

Ndaj në këtë cikël, përveç medimit për gjendjet e natyrës njerëzore, dallohet qartë shqetësimi për fatin e njeriut, edhe të popujve, fati i cili varet prej politikave globale apo lokale. Shqetësim të këtillë shfaq autori në poezinë Luaj me glob... ku enden gjurmët e ankthit atomik të Luftës së Ftohtë ndërmjet superfuqive të botës:

*...Nesër ka me lindë foshnja që nuk di me geshë
e ka me i pa mërrolët popuj e kultura
Tash merre me mend
një njerëzim i tërë
fle me kokë në bombën atomike
dhe mban një shpresë të lidhur lak në fyt*

Me gjuhën e imazheve poetike

Në ciklin e pestë Imazhe poeti parapëlqen të flasë me gjuhën e imazheve që shpesh u ngjasojnë imazheve piktoreske duke tentuar një retrospektivë në kohë parake: të kapjes së çastit të para ndodhjes së ngjarjes, që ta sjellë ndërmend reflektimin e një ylli, drita e të cilit vijon të udhëtojë deri tek ne por, në fakt, ai është shpërbërë prej kohësh. Imazhet lindin nga një proces psikik ku vetëdija dhe pavetëdija ndërhyjnë tek njëra-tjetra, pa e sqaruar mirë kufirin me realitetin. Disa prej poezive kanë pikërisht të njëjtin titull (Imazh I, Imazh II, Imazh i kthjelluar, Çaste). Në këtë proces poeti, si një shaman i urtë, reket ta rikthejë çastin e ikur, ta kthejë kohën pas si mundësi për t'i ndrequr gjërat ndryshe si në poezinë Imazh II:

*Kjo qershi e kalbur n' degë
është rasti yt i harruar me buzëqeshë
...Unë edhe pse sajoj imazhe për qejfin tim
nuk gjej dot mundësi me e kapërcye këtë ligj
pos nëse e vendos ngjarjen
në çastin para kalbjes*

Ndërsa në poezinë Çaste tentohet ikja nga lëndorja, fizikja, duke u zhdukur pas metafizikes në një botë dhe në një kohë që është boshe:


*Nuk jam këtu, kot vini, nuk jam,
është orë e trajtës së kotë
i fshetur diku siç fshihemi nga vetja
bëj çastin e mungesës në botë...*

Gjuhë të imazheve ka edhe në poezinë Riprodhim, në të cilën çmitizohet përsëri bota përmes vështrimit ironik të ekzistencës, e cila nuk ka më asgjë origjinale, të papërsëritshme por, përkundrazi, duket si e kopjuar për të kushedi të satën herë. Bota ngjason me një pikturë që përsëritet përjetësisht, që ndërrohen ngjyrat, që ndërrohen njerëzit, por piktura mbetet, jeta dhe ekzistenca vijon pavarësisht se kjo ngjan me një pikturë të riprodhuar:

*Kjo pikturë është e kopjuar
ai lumi që shihet aty rrjedh i pasigurt
ajo vajza që rri në breg
duket qartë se nuk e pëlqen këtë motiv
do një tjetër më optimist
... Pema afër saj tashmë i ka shkundë gjetet
një brushë dhe ca ngjyra tjera
ndodhen aty për me ndërru efektet
Gruaja ndien se është koha të çohet
një tjetër vajzë vjen e ulet në vendin e saj
brusha e ngjyrat janë prapë aty
efektet megjithatë s'ndërronin*

Libri poetik Njëpër galaktikën që e ke krijuar vetë ka për bazë poetizimin e gjendjeve metafizike komplekse ku ndërthuren përjetimet e thella subjektive me filozofinë e njeriut bashkëkohor, pjesë e së cilës janë kërkesa për artin poetik, lidhja me atdheun në kohët moderne, pësia e rëndë e situatave absurde dhe e palumturisë së një bote në udhëkryq. Ligjërimi i kësaj poezie manifeston veçori të ligjërimin narrativ, gjithsesi një narrativë poetike ku çlirohet reflektimi i gjithanshëm i poetit që jeton në botë.

VAJTJEARDHJET E PUSHTUESVE (ose robërit e qetë)



AHMET SELMANI

"Skllavëria, si çdo pësim tjetër, pasi rëndon ca kohë në kurriz, bëhet më në fund një zakon i pëlqyer" (Faik Konica)

"Skllavëri, bij skllavëri, s'e meritoni, se liri s'doni!" (Fan S. Noli)

Pas theqafjes së pritur të Perandorisë Osmane më 1912, befas ia behu ushtria serbe me një furi egërshane, pastaj njëllon ndodhi edhe me atë bullgare, e nuk vonoi shumë kohë, sërish u dilnin forcat serbe, në vazhdim rishtazi sulmuan ato bullgare etj.

Kështu, nga njëri vit në tjetrin, pushtuesit e vjetër dhe të rinj pothuajse vejevinin si erërat e acarta nga malet, ndërkaq vendësit e shtypur nga mizoritë e shumta të tyre sikur u mësuan me nënshtrime të njëpasnjëshme, madje në një mënyrë sikur u bënë edhe vartës të robërisë. Thënë fare thjesht, me këtë sjellje të paparë u krijua një përshtypje se pushtuesit e tillë mësynin dhe largoheshin kur t'ua thoshte ëndja e tyre, pa hasur në ndonjë qëndresë e cila do të mund t'i thyente apo t'i zmbrapste.

Prandaj, në ato vite tepër të brishta e të mjegullta, pasi kaloi edhe një dimër i ashpër plot me borë e ngrica, në prag të pranverës banorët zunë të dilnin nga shtëpitë e tyre duke bredhur rrugicave të katundeve. Dhe teksa gëlonin kokë më kokë në ndonjë shtrojerë, biseda kryesore e tyre ishte ajo për luftërat dhe pushtuesit. Tanimë ato ishin bërë aq shumë sa edhe nuk u bënte fort përshtypje, e lëre më ta trazonin zjarrin me ndonjë veprim kryengritës. Fatin e robit thuajse e kishin pranuar si një normalitet.

- Kushedi cilin do të na e sjellë kjo pranverë?! Kur bulon gjethi i pemëve, thonë se vijnë edhe pushtuesit. Hë, si thua, kush e ka radhën të vijë sivjet? - pyeste njëri me gjakftohësi të çuditshme.

- Me sa duket, tani do na vijë bullgari... - gjegji tjetri duke përdredhur mustaqet e thinjura me gishtërinjtë e plasaritit.

- Ç'thuhet more? Po bullgari ishte njëherë, ndoshta tani e ka radhën serbi!? - sërish ndërhyri tjetri.

- Po edhe serbi ishte... - ia priti i pari.

- Atëherë duhet të vijë turku... - sakaq brofi tjetri gati si i mallzuar.

Kështu ata bjerraditëshin në ndonjë cep të rrugës duke dredhur cigare e duke lozur cicmic me gurë. Meqë ishin bërë shumë vite nën pushtime të ndryshme, tanimë e kishin humbur ndjesinë e vërtetë për luftën dhe paqen. Ndaj këto të dyja u ngjasonin krejt njëllon. Thjesht ishin shndërruar në robër të qetë që nuk i kundërviheshin asnjë pushtuesi.

LAKMIA PËR FRONIN E SHQIPËRISË

(ose princi me rreth të paprerë)

"Të qenit në pushtet, patjetër duhet të jetë kënaqësi e madhe, pasi shumë njerëz dëshirojnë ta rëmbejnë" (Volteri)

Shqipëria e sapoliruar nga kthetrat e sundimit të gjatë osman, sado që me një

tokësi të tkurrur në mënyrën më të llahtarshme, për çudinë e çudirave, sërish u bë një vend i lakmuar nga shumë oborre mbretërore të vendeve evropiane dhe më gjerë. Sipas dëshmimeve të asaj kohe, i pari që synoi ta zinte fronin e saj ishte duka i Montpesierit, princi francez Franc Ferdinand Bourbon - Orleans. Dhe pastaj, për rrëmbimin e këtij fronti përpiqeshin edhe dy pasardhës të Gjergj Kastriotit - markezi italian Di Aluetta dhe fisniku spanjoll Don Juan Aladro Castriota y Perez y Velasco. Ndërkohë një nga lakmitarët e tjerë të fronit në fjalë ishte edhe princi Albert Gjika, i cili rridhte nga një derë bujare rumune me prejardhje shqiptare. Në anën tjetër dëgjoheshin edhe zëra se nga princi austriak Franc Ferdinandi dhe nga Vatikani ishte propozuar duka Vilhelm Herzog von Urach. Edhe familja e Bonapartëve për fronin shqiptar nxori emrat e tre kandidatëve: princ Viktorit, princ Louisit dhe princ Rolandit. Mëtues të tjerë për fronin mbretëror të Shqipërisë ishin edhe gjermanët me Mauricio Schonbourg - Lipenin, dukën Karl von Urach, princin Karl von Hohenzllern dhe princin Vilhelm Friedrich Heinrich Von Vied; anglezët me Arthur of Connaughtin; suedezët me dukën Vilhelm Soedermandland dhe dukën Karls Vestgothland; danezët me princin Aksel etj.

Një familje e cila synonte për fronin princëror ishte edhe ajo e fisit katolik në Shqipëri, pra ajo e Prenk Bib Dodës. Shpresa për ta marrë fronin shqiptar kishte edhe mbreti malazias Nikolla. Përveç këtyre, për fronin shqiptar u përpoqën edhe disa kandidatë me besim islam. Kështu Porta e Lartë për këtë fron propozoi Abdyl Mexhidin, Burhan Medinin dhe generalin Ahmet Izet Pashën me prejardhje shqiptare nga Manastiri. Një figurë e parapëlqyer ishte edhe ajo e princit egjiptian Ahmed Fuad Pashës, pasardhës i derës së familjes së Mehmet Ali Pashës, i cili ishte themelues i Egjiptit modern.

Mirëpo, pas kësaj lufte të ashpër politike dhe diplomatike, fronti aq shumë i përfolur e i lakmuar iu besua Vilhelm Vidit. Pas bredhjes nëpër kryeqytetet evropiane për t'u njohur dhe paraqitur si princ i Shqipërisë, më në fund ai mori udhën për në Shqipëri. Dhe më 7 mars të vitit 1914, me anijen austriake "Taurus", e shoqëruar edhe nga tri anije luftarake italiane, angleze dhe franceze, ai zbarkoi në bregdetin shqiptar. Me këtë rast çifti, princ Vidi dhe princesha Sofia, u pritën në portin e Durrësit, të cilin e zgjodhi si kryeqytet, ku një ndikim të madh kishte edhe Esat Pashë Toptani. Ndonëse këtë pa u mëdyshur e emëroi ministër të Luftës, zyrtarisht deklaroi se e mirëpriste ardhjen e Vidit si princ të Shqipërisë, por nga ana tjetër fshehurazi vazhdoi ta nxiste lëvizjen kundër tij me synimin për të sjellë një princ me besim islam.

- Jo, nuk na duhet një princ me atë sendin e paprerë! - thoshin gjithë kohën e lume shërbëtorët e tij tinëzarë.

- O njerëz, princ Vidi nuk ka ardhur të na i shkërdhejë gratë, por për ta udhëhequr vendin tonë, - sakaq sqaronin të tjerët duke ua hedhur poshtë arsyetimin esadistëve.

Në këtë mënyrë, herë duke ngulmuar njëra palë, e hera pala tjetër, më në fund shpërtheu një kryengritje kundër tij. Ndaj princi Vilhelm Vidi me rreth të paprerë, pas gjashtë muajsh u detyrua ta braktiste Shqipërinë e brishtë duke e lënë në duart e gjithkujt dhe të askujt. Pas zbimit të tij, të gjithë dukeshin si mbretër dhe si mjeranë njëkohësisht. Tragjedia dhe komedia luheshin para syve të tyre.



**ABDURRAHIM KARAKOÇ
JE TI**

*Në tezgën e zezës poezi kam qëndisur
Në perin qëndisësh je ti
Kam lexuar ligjin e rrugës së dashurisë
Në paragrafë me radhë je ti*

*Në luginën e mendimit një lumë kalon
Përkulen selvitë e ujë pinë
Në gjoksin tënd çelin zambakët e hëna lind
Në rrjedhjen e heshtur je ti*

*Je uji esencial i shishes së quajtur jetë
Je shkaku i pikëllimit dhe lumturisë
I të rënit dëshmor ballë dashurisë
Në vështrimin e pashkëlqim je ti*

*Gjithmonë në ngjyrën tënde duket pranvera
Në gjethe ke gjelbërimin e erën trëndafil
Të arnuara plagët në zemrën time
Në qepjen e tyre radhë-radhë je ti*

*Mos u lodh larg duke shkuar
Vetëm ti eja në mua kërko
Retë vjollce të diellit tim
Në hyrje-daljen e tyre je ti*

KARAKOÇ, Abdyrrahim

Abdyrrahim Karakoç (1932-2012) ka lindur në Kahramanmarsh. Ka qenë poet dhe gazetar. Sa ishte i vogël kishte kureshtje për poezinë për shkak se edhe gjyshin edhe babanë i kishte poetë. Kjo poezi është përkthyer dhe publikuar në revistën "Akademia".



ÖZDEMİR ASAF

LUMTURI PAS MEJE

*Kam jetuar tërë këto vite
Kam humbur të gjitha që në dorë më kanë rënë
Do të jetoj edhe pak
Vetëm një gjë kursyer kam*

*Një shikim, një vëzhgim, një shqisë, një mendim
Ndoshta i uritur do të mbes*

*Do të fajsohem kur do vdes
Kam shkruar pak,
Po tash do të shkruaj më shumë*

ÖZDEMİR ASAF

Özdemir Asaf (1933-1981) ka lindur në Ankara. Studimet për drejtësi i ka përfunduar në Universitetin e Stambollit. Është i njohur si poet. Kjo poezi është përkthyer dhe publikuar në revistën "Akademia".



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

Çerkini: Gabimet si vendës i kushtuan Ferizajt

"KF Ferizaj, prej gjashtë ndeshjeve të zhvilluara, ka grumbulluar vetëm gjashtë pikë si pasojë e gabimeve në ndeshjet si vendës" është shprehur mbrojtësi Dardan Çerkini. "Në gjashtë xhirot e para kemi bërë disa gabime, sidomos kur kemi luajtur si vendës. Nuk guxojmë të lëshojmë pikë kaq lehtë kur jemi para shikuesve tanë, por duhet që edhe si mysafirë të angazhohemi që të marrim më të mirën e mundshme. Normalisht se nuk jemi të kënaqur me rezultatet e arritura, por besoj se kjo do të ndryshojë në ndeshjet e ardhshme", ka thënë Çerkini



shkojmë në Drenas që ta japim maksimumin dhe të shohim çfarë rezultati mund të nxjerrim. E mira është se nuk kemi asnjë mungesë për këtë ndeshje kaq të rëndësishme".

Skuadra e Ferizajt e ka mposhtur Dritën në xhiron e parë (0-1) dhe në xhiron e pestë Dukagjinin (0-1), kurse ka pësuar humbje nga Gjilani (0-3), Flamurtari (1-0), Vushtrria (0-1) dhe Drenica (0-1). Fakt interesant është se kjo skuadër në dy ndeshje ka fituar me vetëm një gol të shënuar dhe ka humbur në tri ndeshje po ashtu me vetëm një gol të pranuar.

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 26 SHTATOR - Skuadra e Ferizajt pati një seri fantastike në fund të kampionatit të kaluar me çka kulmoi edhe mbetja në IPKO Superligë pa pasur nevojë të luajë në ndeshjet e barazhit. Në afatin kalimtar të verës u bënë disa ndryshime në klub, përfshirë trajnerin, futbollistët dhe investitorët. Mirëpo kjo nuk e ka ndihmuar këtë klub ta nisë në mënyrën më të mirë kampionatin 2019/2020, pasi nga

gjashtë ndeshjet e zhvilluara ka regjistruar dy fitore dhe katër humbje. Futbollisti i kësaj skuadre, Dardan Çerkini, ka thënë të enjten për "Epokën e re" se nuk është i kënaqur me rezultatet e regjistruara, por beson se kjo situatë do të ndryshojë. "Në gjashtë xhirot e para kemi bërë disa gabime, sidomos kur kemi luajtur si vendës. Nuk guxojmë të lëshojmë pikë kaq lehtë kur jemi para shikuesve tanë, por duhet që edhe si mysafirë të angazhohemi që të marrim më të mirën e mundshme. Normalisht se nuk

jemi të kënaqur me rezultatet e arritura, por besoj se kjo do të ndryshojë në ndeshjet e ardhshme", ka thënë Çerkini. Skuadra e Ferizajt në kampionatin e kaluar kishte arritur që të befasojë Feronikelin në Drenas, kurse ndeshjen e javës së shtatë e ka pikërisht ndaj kësaj skuadre në

stadiumin "Rexhep Rexhepi". I pyetur se a është Ferizaj në gjendje sërish ta përsërisë befasinë e xhiros së kaluar, Çerkini është përgjigjur: "Sa i përket ndeshjes së ardhshme ndaj Feronikelit mund të them se është e vështirë, sepse kundërshtari është kampion në fuqi dhe fitues i Kupës. Ne do të

IPKO SUPERLIGA

Të shtunën takohen:
Feronikeli - Ferizaj
Llapi - Dukagjini
Trepça '89 - Flamurtari

Të dielën takohen:
Gjilani - Drita
Vushtrria - Prishtina
Drenica - Ballkani

Rikthehet basketbolli, të dielën derbi Rahoveci - Prishtina

PRISHTINË, 26 SHTATOR - Edicioni i ri në Superligën e Kosovës në basketboll fillon sot (e premte) me ndeshjen ndërmjet Bashkimit dhe Lipjanit që zhvillohet në Gjakovë nga ora 19:00. Kjo përballje zhvillohet në Gjakovë për shkak se palestra në Prizren është e zënë, kurse të shtunën do të përballen Golden Eagle Ylli - Feronikeli.

Të dielën nga ora 17:00 takohen Ponte Prizreni me Pejën, i cili është rikthyer në Superligë. Java e

parë mbyllet me superderbin ndërmjet Rahovecit dhe Sigal Prishtinës. Ky takim zhvillohet të dielën nga ora 19:00 në "Mizahir Isma". Këto dy skuadra u takuan edhe në Superkupë, ndërsa edicionin e kaluar ishin ndeshur edhe në finale të "play-off"-it dhe Kupës, ku triumfuan prishtinasit. Trepça do të pushojë në xhiron e parë. Në këtë edicion do të zhvillohen 36 xhiro gjithsej. Dy skuadrat e fundit bien nga elita, kurse skuadra e shtatë e renditjes



në Superligë do të takohet me finalistin e Ligës së Parë, për një

vend në elitë për edicionin e ardhshëm.

XHIROJA E PARË NË SUPERLIGË

Të premten takohen:
19:00 Bashkimi - Lipjani

Të shtunën takohen:
19:00 Golden Eagle Ylli - Feronikeli

Të dielën takohen:
17:00 Ponte Prizreni - Peja
19:00 Rahoveci - Sigal Prishtina
Trepça (pushon)

KF Dukagjini: Padrejtësitë ndaj nesh janë të mëdha

KLINË, 26 TETOR (ER) - KF Dukagjini ka reaguar të enjten në lidhje me padrejtësitë që po i bëhen nga gjyqtarët në këtë edicion të IPKO Superligës së Kosovës në futboll. Në reagimin e gjatë të Klubit nga Rrafshi i Dukagjinit thuhet se në gjashtë ndeshjet e para padrejtësitë kanë qenë jo të pakta në numër dhe si pasojë e tyre janë mohuar edhe pikët. "Klubi i Futbollit Dukagjini nga Klina është tejet i shqetësuar

dhe i habitur me mënyrën e referimit që po i bëhet skuadrës sonë që nga fillimi i këtij kampionati. Si rezultat i këtij referimi skuadrës sonë i janë mohuar pikët e plota në shumë raste, por edhe ka ndikuar në rezultat final të ndeshjes. Klina si qytet i vogël, por me një zemër të madhe dhe dashuri për futbollin, i ka ofruar Superligës një ekip simpatik, me shikueshmëri dhe tifozë që as ekipet kampione

në Kosovë nuk e kanë", thuhet në reagimin e kësaj skuadre. Skuadra nga Klina cilësohet si ndër skuadrat më korrekte në Superligë në lidhje me organizimin e ndeshjeve, por edhe me sjellje të shikuesve. Klubi nga Klina pretendon se në disa ndeshje janë dëmtuar drejtpërdrejt nga gjyqtarët. Ndeshjet që pretendon Dukagjini që janë dëmtuar janë ndaj Ballkanit, Dritës, Flamurtarit, Ferizajt si

dhe në ndeshjen ndaj Prishtinës. "Kërkojmë nga organet e Federatës së Futbollit të Kosovës që të merren masa dhe të reagohet urgjent ndaj këtyre gjyqtarëve dhe të tjerët që bëjnë këso veprime të cilat janë vërtet tendencioze dhe po e dëmtojnë klubin, në të njëjtën kohë edhe janë imazh i keq tek investitorët dhe donatorët. Tash e tutje mirëpritja dhe respekti do të jetë pasqyrë e asaj se si do të refero-



het kur luan klubi ynë", thuhet në reagimin e KF Dukagjini.

Presidenti Meta, tifoz i Celticut

TIRANË, 26 SHTATOR - Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta, përveçse angazhimeve në politikë, njihet për mbështetjen që i jep sportit, veçanërisht futbollit. Përveç

kombëtares, Meta mbështet edhe skuadrën skoceze të Celticit. Gjatë një vizite në Sarajevë gjatë kësaj vere, aty ku Celticu luante me ekipin boshnjak, tifozët i kanë bërë një sur-

prizë presidentit që i ka mbetur në mendje. Kështu ai është deklaruar si një tifoz i Celticut. Me anë të një postimi në "Twitter", presidenti ka shkruar duke uruar për fitoren: "5-0.

Hej djema, a keni luajtur futboll apo tenis? Ju thujse rrëzuat portën e kundërshtarit. Jeni të mrekullueshëm. Fat të mirë në gjysmëfinale! Once you're Celt you're always a Celt".



FFK-ja merr lëvdata nga UEFA



PRISHTINË, 26 SHTATOR - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi dhe sekretari i përgjithshëm, Eroll Salihu, kanë zhvilluar sot një takim me shefin e edukimit të UEFA-s për zhvillimin e elitës U15, Jean Francois Domergue, e ku ishin të pranishëm edhe përzgjedhësi i Kombëtares, Bernard Challandes dhe drejtori teknik Michael Nees. Në këtë takim u bisedua për

strategjinë e FFK-së për kategoritë e reja, përfshirjen e shkollave dhe zhvillimin e gjithëmbarshtëm të futbollit. UEFA e ka pranuar në tërësi programin strategjik të FFK-së, i cili është vlerësuar si projekt i shkëlqyeshëm dhe tani do të fillojë zbatimin e tij në përpikëri. "Domergue u zotua se do ta përkrahë dhe do ta ndihmojë FFK-në për realizimin e këtij projekti që, sipas tij, është shembull

për regjion. Po ashtu, në emër të UEFA-s Domergue lavdëroi zhvillimin e hovshëm të FFK-së dhe theksoi se UEFA është e kënaqur për zhvillimin dhe realizimin e këtyre projekteve", thuhet në njoftimin e FFK-së. Shefi i edukimit të UEFA-s gjatë ditës së nesërme do të vizitojë disa qytete të Kosovës për të parë se si po aplikohet në praktikë kjo strategji e FFK-së.

SHKURT

Hoxha: Thyejmë Tiranën dhe fitojmë sërish titullin

Kapiteni i Partizanit dhe portieri i Kombëtares së Shqipërisë, Alban Hoxha, ka folur për derbin e së dielës, duke thënë se të kuqtë janë gati për ta thyer sërish Tiranën. "Është një sfidë delikate, tifozët dhe opinionin e ndjekin shumë derbin. Megjithatë, derbi ka treguar se nuk ka shumë rëndësi klasifikimi, por dëshira për ta fituar. Ne e kemi të madhe dëshirën për t'i marrë 3 pikët ndaj Tiranës", ka thënë Hoxha. Por, sidoqoftë, këtë vit gjërat do të jenë ndryshe dhe Hoxha e pranon këtë fakt: "Tirana është forcuar dhe tashmë vijnë edhe ndeshjet e vështira për të gjithë ekipet. Tashmë Tirana do të duket më qartë. Është hera e parë që Tirana është moralisht më mirë se ne. Ndaj të gjithë duhet që të japim më të mirën në këtë derbi".

Messi mungon ndaj Getafes, rrezikon edhe ndaj Interit

Pas disa minutave të diskutuara në Dortmund dhe Granada, Lionel Messi u rikthye si titullar me Barcelonën në sfidën e dy ditëve më parë, atë ndaj Villarealit, por ishte i pafat, pasi pësoi një tjetër dëmtim. Ylli argjentinas la fushën e lojës për një problem muskolor, ndërsa sipas medieve spanjolle është e sigurt mungesa e tij në sfidën e fundjavës ndaj Getafes, por rrezikon edhe prania në ndeshjen ndaj Interit në "Camp Nou" më 2 tetor. Gjatë ditëve në vijim priten të tjera përgjigje nga gjendja fizike e Messit, teksa nëse do të konfirmohet mungesa e tij në Champions, atëherë Valverde duhet të shqetësohet, pasi Barça nuk ia doli të fitojë as në ndeshjen e parë të fazës së grupeve.

Alves: Neymari nuk është i lumtur në PSG

Ish-lojtari i Paris Saint-Germainit, Dani Alves, ka folur për Business Insider rreth situatës së Neymarit. "E kam thënë disa herë që lumturia e tij është në Barcelonë. Mendoj se ai do të kishte gjetur lumturinë nëse do të vazhdonte atë që la përgjysmë aty. Kur je i lumtur diku, kërkon të shkosh përsëri aty dhe mendoj se këtë gjë u mundua të bënte", ka thënë Alves. Neymari tashmë e ka humbur mbështetjen e tifozëve të PSG-së, megjithëse vazhdon të shënojë gola të rëndësishëm për klubin.

Wengeri, gati ta marrë drejtimin e Unitedit

Ish-trajneri i Arsenalit, Arsene Wenger, ka thënë se është i gatshëm ta marrë drejtimin e skuadrës së Manchester Unitedit. "Drejtimi i Unitedit është një punë që e ëndërron secili trajner. Unë kam vetëbesim, kurajë dhe ide", ka deklaruar Wengeri për "beIN SPORTS".

Puyoli refuzon Barçën

Ish-kapiteni i Barcelonës, Carles Puyol, ka refuzuar mundësinë e ribashkimit me skuadrën tij si menaxher i përgjithshëm në vend të Pep Seguras, i cili u largua në korrik. Presidenti Josep Maria Bartomeu, ka thënë këtë muaj se po shpresonte ta bindte Puyolin që të rikthehej në "Camp Nou", ku ai luajti për gjatë gjithë karrierës së tij, mes viteve 1999-2014. "Pasi u mendova shumë për këtë, vendosa të mos e pranoj ofertën e klubit. Nuk ishte një vendim i lehtë", ka thënë Puyol. "Unë gjithmonë kam thënë se do të doja të kthehesha në vendin që e konsideroja si shtëpinë time, por projektet e ndryshme personale, në të cilat gjendem në këto çaste, do të më ndalonin ta jepja përkushtimin ekskluziv që ky rol e meriton", ka shtuar Puyol.

Ribery i rilindur te Fiorentina



FIRENCE, 26 SHTATOR - Frank Ribery u largua nga Bayern Muncheni me një ide të qartë pas 12 vjetëve, 425 ndeshjeve, 124 golave dhe 182 asistimeve të dhuruara: të vazhdonte të luante futboll ashtu sikurse Francesco Totti deri në moshën 40-vjeçare. Refuzoi oferta të larta nga Qatari dhe ofertat faraonike nga Kina vetëm për t'u treguar të gjithëve që vijon të ketë nivel për të luajtur në elitë. Te Fiorentina po tregon se moshja 36-vjeçare nuk e

pengon për asgjë. "Nëse më sjellin një futbollist si ai do t'u ofroj drejtuesve një darkë në shenjë falënderimi", kishte deklaruar Montella, dhe duket se ky vlerësim ka qenë i drejtë. Ribery u bë pjesë e ekipit vjollcë kur ishte jashtë forme e, në fakt, ka luajtur vetëm 240 minuta, ku në dy ndeshjet e para erdhi nga stoli, ndërsa në 3 të fundit luajti titullar. Kaq i ka mjaftuar të shndërrohet në një nga figurat kryesore të kampionatit italian.

Shënoi një gol të rëndësishëm pas pasimit të Federico Chiesas në barazimin 2-2 ndaj Atalantës dhe dha një asistim për Pezzellan, që i ndihmoi Fiorentinës të fitojë 2-1 me Sampdorion. Francezi është futbollisti i dytë që ka më tepër gjuajtje drejt portës në Serinë A. Kjo vërtetohet se moshja nuk ka ndikuar në formën dhe cilësitë e Ribery, i cili, me sa duket, ka pasur forcë për të vijuar edhe te Bayerni, por tani shkëlqen te Fiorentina.



| | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|--|-------------------|-----------------------|---|---|------------------------------------|------------------------------------|---|---|---|----------------------|---|---|---|----------------------------|--|--|--|--|--|---|---|
| Autor: GAZMEND MORINA | KEQTINGË- LLIM | MALLKIMI NGA KISHA | BANJË ALLATURKA (shq.) ELEMENT KIMIK (shq.) | AKTORJA ME FAMË BOTËRORE REID | PËRSHKRIMI I NJË UDHËTIMI | SUDOKU | | | | | | | | | | | | | | | |
| SECILA NGA FLETËT QË MBYLLIN DRITAREN A DOLLAPIN (shq.) | | | | | | 6 | 1 | | 5 | | | | | | | | | | | | |
| SHPIRT (Latinisht - sh.shq.) | | | | | | 5 | 7 | | | 9 | 2 | 3 | | | | | | | | | |
| SHTET NË AZI | | | | | | | 7 | | | 9 | | | | | | | | | | 8 | |
| TURK I VJETËR | | | | | | 2 | | | | 7 | | | | | | | | | | 4 | |
| MJET ELEKTRIK PËR TERJEN E FLOKËVE (shq.) | | | | | ELBASANI PJESË E KOMPJUTERIT | 8 | 6 | 9 | 1 | | | 5 | | 7 | | | | | | | |
| NJËSIA E REZISTENCËS ELEKTRIKE | | | | DY BASHKË- TINGËLLORE I GDHEND | | | | | | 2 | 8 | 6 | 9 | | | | | | | | |
| NATRIUM | | | FRIKACAKET IMITUES | | | | | | | 6 | | | | | | | | | | 1 | 3 |
| | | | | | | CLINICAL INFECTIOUS DISEASES | | | | GRIMCË MOLEKULARE | | | | AKTORI TURK IMRZALIOGLU | | | KALIBËR I TYTËS SË ARMËS (shq.) | | LIQEN I MADH NË AMERIKËN JUGORE | | |

| | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|--|---|--|--|------|---|--|--|--|---|--|--|--|--|--|--|---|--|--|-----------------------------|--|-----------------------|--------------------|
| EPOKA ERE | AKTORJA KANAEZO- AMERIKANE NË FOTO | E DASHURA E POPAIT | "ERA DHE ..." | KYÇI | "KENIA" | ZANORE | E QESHURA TALLËSE PASURITË E PATUNDSHME QË SILLNIN TË ARDHURA | | | | | | | | | | | | | | | |
| BANORE E NJË SHTETI TË MADH NË EVROPË | | | | | | | SIMBOL I FESË MYSLIMANE, BESIM MERR TË PLASUR, ÇAHET PAK | | | | | | | AKTORJA QOSJA BËRJA MË I RI | | | | | | | | |
| PARAGRAF | | | | | | PARIM I QARTË E I PËRCAKTUAR MIRË KËNGËTARJA HUTA | | | | | | | | | SHTET NË AFRIKË KASA | | | | | | | |
| FEMRA E ZGJEDHUR NË NJË KONKURS BUKURIE | | | | | ARTI I TË FOLURIT BUKUR GRUP PREJ TRE MUZIKANTËSH | | | | | | | | | | | "NOKETA" DHELPARAK | | | | | | |
| | | | | | POLITIKANI SHQIPTAR SHEHU DY BASHKË- TINGËLLORE | | | | | | | | NATIONAL REGISTRATION DATABASE KËNGËTARJA GJERMANE SARA (shqip.) | | | | NAIM ABAZI LLOJ BIMË QË PËRDORET SI ERËZ PËR GJELLË | | | | | |
| FUTBOLLISTI SHQIPTAR MUKA NOTË MUZIKORE | | | BËJ COPË- COPË NJË LETËR (sh.shq.) MURG I VETMUAR | | | | | | | | | | BIMË QË BËN KOKRRA TË THARA BAKËR | | | | | | | | | |
| ZANORE | PATRIOTI DURAKU AKTORI ZHITOPOTOKU | | | | | | | | TOROLLAKU NJËSI KOHE | | | | | | | | | | AUSTRIA PRAROJ | | | |
| "R" pas dy "A" | | | | | FUTBOLLISTI ITALIAN MASIMO FUTBOLLIST I NJOHUR BRAZILIAN | | | | QYTET NË FRANCË (shq. - shqip.) NJËSI E MADHE USHTARAKE (sh.shq.) | | | | | | TITULL OSMAN EMËR FEMRE MYSLIMANE | | | | | EMËR YNI DJALI | | |
| TËRËSI E VETIVE A E TIPAREVE MORALE TË NJERIUT | | | | | TOKA E BUKËS NËNDARJA E NJË LIGJI | | | | | MIMOZA OSMANI TAKSË (sh.pashq.) | | | | BASHKIM I HARMONISH- ËM I DISA TINGUJVE GRIMCOVA (bised.) | | | | | | | | |
| QENIE MBINJERËZ- ORE ME FUQI TË FSHEHTË (mit.) | | | | | | TË BUKURIT ALMIMA (perkdh.) | | | | | | | | | | SHPEND UJI SHTËGTAR KAFSHË SHTËPIAKE (shq.) | | | | | | |
| REPER I NJOHUR AMERIKAN | | | | | | | PËRFUNDIM NË SHAH KËNGËTARJA AMERIKANE TARNER | | | | | | | | SHOK SHTËT NË AMERIKË | | | | SELEN MJET SHPËRTHYES | | | |
| RAVENA | | KËNGËTARE E NOHUR ANGLEZE (T. T.) KAMPIONI | | | | | | | | | | | | | | | | | | NANTES KLUB FUTBOLLI NË SUEDI | | |
| NË CFARË MASE AGJENCIA E ZBULIMIT E IZRAELIT (shqip.) | | | | | KUFIZIMI ALYSSA MILANO | | | | | | | | | | | | | | | | SHKRONJA TË NJËJTA | |
| | | | | | | SHKENCËTARI YNË SKËNDER AZOT | | | | | | | | | | | | | | | | I FILLOJ ZANORE |
| AKTORI YNË MUÇAJ | | | | | | | ZBRITJA E AVIONIT NË TOKË | | | | | | | | | | | | | | | BOSHT |

ZGJIDHJA E FJALËKRËYQIT: H. KANATI, ANIMAT, KATARI, OTOMAN, FENI, E. OMI, SR, NA, IKACAKET, I, ILARITETI, POLAKE, IMAN, DONAT, ALINE, KRITER, MALI, MISI, ORATORIA, NOK, DEVI, TRITAN, NRD, NA, LA, GRISET, KIKIRIKI, A. EMIN, TOROMANI, A. AAR, ODO, RENI, AGA, NDER, ARA, MO, AKORD, DEMON, ART, RIM, NOR, EMINEM, MAT, MIK, SE, R, TANITA TIKARAM, N, SA, LIMITIMI, ELIA, MOSAD, ANAMALI, I NIS, NIMON, ATERIMI, AKS. ZGJIDHJA E SUDOKUT: Kolona I: 621 357 489; KII: 394 288 751; KIII: 587 419 236; KIV: 473 592 168; KV: 956 841 372; KVI: 218 673 945; KVII: 869 134 527; KVIII: 135 728 694; KIX: 742 965 813.



SHKOLLA E MESME E AGROBIZNESIT DHE TEKNOLOGJISË
"ABDYL FRASHËRI"
Nr. 288
DL 26.09.2019

SHKOLLA E MESME E AGROBIZNESIT DHE TEKNOLOGJISË "ABDYL FRASHËRI" - PRISHTINË

SHMAT "Abdyl Frashëri" në Prishtinë në bazë të Udhëzimit Administrativ nr.02/2016 neni 11, datë 12.01.2016 si dhe Vendimit të Këshillit të shkollës të datës 25.09.2019, për organizimin e Ekskursionit në Republikën e Shqipërisë shpall:

O F E R T Ë

Njoftohen agjensionet turistike-transportuese se SHMAT "Abdyl Frashëri" në Prishtinë, organizon ekskursion për 90 nxënës në Republikën e Shqipërisë, më qëndrim kohor katër (4) bujtje me pansion të plotë.


Në ofertë të paraqitet çmimi i akomodimit dhe shpenzimet e ndryshme që paraqiten me rastin e vizitave në vende turistike, muze, keshjtjella etj. që parashihen në itinerarin e ekskursionit të përcaktuar nga Këshilli Drejtues i Shkollës

Agjensioni duhet ti ofrojë këto kushte:

1. Ofroj komoditet gjatë udhëtimit dhe qëndrimit në hotel
2. Të sigurojë perkujdesje mjekësore për pjesmarrësit në eskursion gjatë tërë kohëzgjatjes
3. Posedoj licencë për udhëtim jashtë vendit
4. Posedoj mjete transportuese –autobusë personal
5. Posedoj dokumentacionin teknik të autobusëve, sipas procedurave ligjore
6. Mos të ketë referenca negative
7. Të ketë deshmi për shëndetin fizik dhe mendor të ngasësve të autobusëve
8. Autobusët të jenë komfor dhe me klimë,
9. Posedoj tërë dokumentacionin e kompletuar

Oferta mbetet e hapur shtatë ditë prej ditës të publikimit në mjetet e informimit, ndërsa dokumentet dorëzohen në DKA- në Prishtinë.

Prishtinë, 26.09.2019



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria
Vlada-Government
Ministria e Zhvillimit Ekonomik
Ministarstvo Ekonomskog Razvoja-Ministry of Economic Development

Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme /Department za Finansije i Opšte Usluge /Department of Finance and General Services

NJOFTIM PER VAZHDIMIN E AFATIT TË KONKURSIT

Ministria e Zhvillimit Ekonomik zgjat afatin edhe për shtatë ditë kalendrike për aplikim të kandidatëve në Konkursin për pozitën:

Departamenti i Minierave
Divizioni i Politikave Minerare
Vendi i punës: Zyrtari i Lartë për politika dhe strategji minerare - EZHE/280
Numri i Konkursit: APF0006198

për arsye se nuk është arritur numri i balancuar i aplikacioneve nga aspekti etnik dhe gjinor.
Afati i konkurimit vazhdohet prej datës 27/09/2019 deri me date 03/10/2019, deri në orën 16:00.

Vërejtje: Kandidatët që kanë aplikuar me herët për këtë pozitë të punës, nuk kanë nevojë të aplikojnë përsëri. Formularin zyrtar për aplikim dhe informata tjera shtese mund ta gjeni në Web faqen <http://mzhe-ks.net>.

OBAVEŠTENJE ZA PRODUZAVANJE ROKA ZA PRIJAVE

Ministarstvo za Ekonomski Razvoj produžava rok još sedam kalendarski dana za aplikaciju kandidata na konkursu za poziciju:

Departman rudarstva
Divizija za politiku rudarstva
Radno mesto: Viši zvaničnik za politiku rudarstva i strategiju - EZHE/280
Broj konkursa: APF0006198

za to što nije postignut balancirani broj aplikacija sa etničkog i polnom aspekta.
Rok za prijave produžuje se od datuma 27/09/2019 do datuma 03/10/2019 do 16:00 časova
Opomena: Kandidati koji su ranije aplicirali za ovo radno mesto, ne trebaju ponovo aplicirati.
Zvanični obrazac za prijavu i druge dodatne informacije možete preuzeti na internet stranici: <http://mzhe-ks.net>

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Rrahman Mustafa shpall të pavlefshme diplomën e fakultetit të Gjeoshkencës dhe Teknologjisë në Mitrovicë.

► Sinan Mucaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf "Pjeter Budi" Lubizhdë Has

► Luljeta Himaj shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren

► Tatjana Mitrovic shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf "Emin Duraku" Prizren

► Jasmine Braha shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë "Dr. Xhelatin Deda" në Mitrovicë.

► Ibrahim I. Neziri shpallë të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810025355.

► Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qera në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veterikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.


► Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045/699-221.

NJOFTIM

Njoftojmë të interesuarit se me datën 01. Tetor 2019 me fillim në orën 11:00 Kandidatja Mirjeta Salihaj, mbron punimin e Masterit me titull "Efektet ekonomike të prodhimit të qumështit në fermat e buallicave". Mbrojtja publike do të jetë në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë në Prishtinë.



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"



Ref. Nr. Pejë, 26.09.2019

Në mbështetje të nenit 41 paragrafi 1.2.3.4, të Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, Statutin e Universitetit, Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e rekrutimit në Shërbimin Civil, shpallë:

KONKURS

Për plotësimin e këtyre vendeve të lira pune në Administratën e Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë:

Pozita: Zyrtar për Logjistikë- 2 (dy vende punë)

Numri i referencës: UHZ-së /008/19

Lloji i pozitës: jo i karrierës

Kategoria: A

Mbikëqyrësi drejtpërdrejt: Koordinator i logjistikës

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

- Merr pjesë në planifikimin dhe përgatitjen e programit në fushën e logjistikës;
- Ofron mbështetje teknike dhe operative për institucion për zbatimin e praktikave më të mira menaxhuuese të logjistikës, sistemeve dhe procedurave;
- Vlerëson sistemet ekzistuese të operacioneve logjistike dhe rekomandon masa përmirësuese që duhet të ndërmerren;
- Procedon të gjitha kërkesat, faturat për mirëmbajtjen e automjeteve, pajisjeve të teknologjisë informative shpenzimeve të telefonit, karburanteve dhe pajisjeve me inventar;
- Sigurojë zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e iniciativave dhe procedurave të reja që lidhen me logjistikën;
- Harton, zbaton dhe menaxhon kontratat për furnizime që ndërlidhen me logjistikën kur është e nevojshme;
- Koordinon të gjitha aktivitetet në lidhje me akomodimin brenda ndërtesës dhe regjistrimin e inventarit;
- Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi;

KËRKESAT / KUALIFIKIMET PROFESIONALE

- Diploma e shkollës së mesme,
- Një (1) vitë përvojë të punës, t' dëshmuar me trust
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURIMIT

Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komunitetet jo - shumicë kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale.

Dokumentet e kompletuara dorëzohen në Rektoratin e Universitetit "Haxhi Zeka" - Pejë, Rr. UÇK-së, p.n. 30000 Pejë, Republika e Kosovës, zyra e protokollit. Formulari për aplikim mund të shkarkohet në (www.unhz.eu).

Konkursi mbetet i hapur 8 ditë nga data e publikimit në mjetet e informimit publik.


Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen. Në procedurën e pranimit të kandidatëve do të bëhet testimi dhe intervista e kandidatëve, të cilët i plotësojnë kushtet sipas konkursit.

Pejë, 2019



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"



Protokol. Br. Peç, 26.09.2019

Na osnovu člana 41 stav 1.2.3.4 Statuta Univerziteta "Haxhi Zeka" u Peçi, Statut Univerziteta, Pravilnik br. 02/2010 o procedurama zapošljavanja u državnoj službi, objaviti:

KONKURS

Za popunjavanje ovih slobodnih radnih mesta u Administraciji Univerziteta "Haxhi Zeka" u Peçi-i.

Pozicija: Službenik za Logistiku - 2 (dva radno mesto)

Broj Protokola: UHZ- /008/18

Tip pozicije: Bez Karijere

Kategorija: A

Direktni nadzornik: Koordinator za Logistiku,

DUŽNOSTI I ODGOVORNOSTI

- Sudjelovati u planiranju i program priprema u oblasti logistike;
- Pruža tehničku i operativnu podršku za instituciju za sprovođenje bolje logistike za upravljanje prakse, sistema i procedura;
- Procijeniti postojeće sisteme logističkih operacija i predlaže korektivne mjere koje treba poduzeti;
- Prosledjuje sve zahtjeve, račune za održavanje vozila gorivo, opreme informacionih tehnologija, troškovi telefona, i opreme namještaja;
- Osigurava praćenje .evaluaciju inicijativa i novih procedura vezanih za logistiku;
- Razvija, implementira i upravlja ugovore za zalihе koje se odnose na logistiku kada je to potrebno.
- Koordinira sve aktivnosti vezane za smještaj unutar zgrade i registruju inventar ;

ZAHTJEVI / STRUČNE KVALIFIKACIJE

- Diploma srednje škole
- Jedno (1) godine radnog iskustva, dokazano povjerenje
- Poznavanje komunikacijske vještine u planiranju rada;
- Poznavanje istraživačke sposobnosti, analitičke, evaluativna
- Sposobnost da ispunji zadatke rada pod pritiskom;

OPĆE INFORMACIJE O KANDIDATIMA KOJI SE ODOSE NA PROCEDURE KONKURSA

Kosovska Civilna služba garantuje jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i pozdravlja aplikacije od svih osoba muškog i ženskog pola svih zajednica na Kosovu.

Ne - većinske zajednice imaju pravo na pravično i proporcionalne zastupljenosti u organima državne službe centralne i lokalne javne uprave,

Kompletna dokumentacija dostavlja se u rektoratu Univerziteta "Haxhi Zeka" - Peçi, Ul. OVK. Bb, 30000 Peçi, Republika Kosovo, u kancelariji za protokol.

Obrazac za prijavu možete preuzeti na (www.unhz.eu).

Konkurs ostaje otvoren 8 dana od dana objave u medijima.

Aplikacije dostavljene nakon roka i nepotpune aplikacije neće biti prihvaćene.

Samo kandidati odabrani na kratkoj listi biće kontaktirani. Na proceduru prijama kandidata održace se testiranje i intervju kandidata koji ispunjavaju uslove konkursa.

Peçi, 2019,

Kërkesa për shprehje të interesit
Emri i shkollës: **“Shaban Polluzha”**
Komuna: **Drenas**
Data: **27.09.2019**

| | |
|----------------------------|----------------------------------|
| Numri i kontratës: | Emri i kontratës: |
| ESIP/SDG/012-CS/1.4 | Trajnim: Gjithëpërfshirja |

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe SHFMU “Shaban Polluzha” Korretic e Epërme, Drenas.

Objekti i nën-komponentit 1.3. (GZhSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t’i planifikojnë dhe t’i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulentëve të nevojshme:
Trajnim: Gjithëpërfshirja

Kualifikimet e firmës konsulente:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulentëve të natyrës së ngjashme.
- Përvojë në trajnimin e mësimdhënësve dhe personelin e shkollës
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhitën në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.

Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme.

Kriteret e vlerësimit:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulentëve nga fusha e Gjithëpërfshirjes (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

Procesi i seleksionimit:
Aktiviteti i prokurimit të do të realizohet në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore” të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK).

Firmat Konsulente të interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën **“Shaban Polluzha” Korretic e Epërme, Drenas, më së largu deri më datën; 07.10.2019**

Firmat e interesuara të konsulentëve mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

Detajet kontaktuese të shkollës:
Personi kontaktues: Drita Curri
Telefoni: 044/180 - 892
E-maili: dcurri@hotmail.com

Njoftimi për shprehje të interesit
Emri i shkollës: **“Krushë e Vogël”**
Komuna: **Prizren**
Data: **27.09. 2019**

| | |
|---------------------------|-----------------------------|
| Numri i kontratës: | Emri i kontratës: |
| ESIP/SDG/086-G/1.1 | Pajisja teknologjike |

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles: **Shfmu “Krushë e Vogël” Krushë e Vogël, Prizren.** Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

1. Përkrahimi i mallrave të nevojshme:
 - **Llaptop** **4 Copë**
 - **Projektor me mbajtës** **3 Copë**
2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:
 - Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e mallrave të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
 - Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.
3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik në adresën: **Shfmu “Krushë e Vogël” Krushë e Vogël, Prizren, më së largu deri më 04.10. 2019.**
4. Specifikimi i hollësishëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-Mallra do t’ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t’i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e Shprehjes së Interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:
Personi kontaktues: Shpresa Shehu
Telefoni: 044/126 622, 044/215 970
E-maili: shehushpresa@live.com

Kërkesa për shprehje të interesit
Emri i shkollës: **“Ibrahim Krasniqi”**
Komuna: **Lipjan**
Data: **27.09.2019**

REPUBLICA E KOSOVËS
KOMUNA LIPJAN
REPUBLICA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN
4 Nr.Br. 610 - 64351
Data/Datum: 26.09.2019

| | |
|---------------------|--|
| Numri i kontratës: | Emri i kontratës: |
| ESIP/SDG/044 | ESIP/SDG/044- |
| | Trajnime për parandalimin e dhunës në shkollë |

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles **“Ibrahim Krasniqi”, Smallushë, Lipjan.**

Objekti i nën-komponentit 1.3. (GZhSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t’i planifikojnë dhe t’i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulentëve të nevojshme:
Trajnim: Trajnime për parandalimin e dhunës në shkollë

Kualifikimet e firmës konsulente:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulentëve të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
- Përvojë në trajnimin dhe punën me personelin e administratës publike ose komunale
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhitën në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.

Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës në fushën Vështirësitë në sjellje dhe emocione të nxënësve në shkollë-menaxhimi i tyre, ngacmimi dhe parandalimi i dhunës në shkollë;

Kriteret e vlerësimit:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulentëve nga fusha e parandalimit të ngacmimit dhe parandalimit të dhunës në shkollë(40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme të dhunës në shkollë(40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

Procesi i seleksionimit:
Aktiviteti i prokurimit të do të realizohet në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore” të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK).

Firmat Konsulente të interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesimit për shërbime konsulente në adresën: SHFMU **“Ibrahim Krasniqi”, Smallushë, Lipjan** më së largu deri më **07.10.2019** Firmat e interesuara të konsulentëve mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

Detajet kontaktuese të shkollës:
Servete Thaçi
Telefoni : 044/361-529
E-mail: th_ela@hotmail.com

Gjej PUNË

• Lajme nga tregu i punës
• Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

CV

facebook www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Industria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

